



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

Vlerësimi i mundësive për bashkëpunim ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe Mekanizmave Evropianë të Mbrojtjes, përfshirë EDA-n, me theksin tek Kosova



VLERËSIMI I MUNDËSIVE PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET BALLKANIT PERËNDIMOR DHE MEKANIZMAVE EVROPIANË TË MBROJTJES, PËRFSHIRË EDA-N, ME THEKSIN TEK KOSOVA


PUBLIKUAR NGA::

© Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

© Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)

AUTORË:

Tringa Naka



Tringa Naka është Udhëheqëse e Operacioneve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), ku udhëheq financat, komunikimin dhe burimet njerëzore. Ajo iu bashkua QKSS-së në vitin 2014, fillimisht duke shërbyer si Zyrtare e Komunikimit dhe Menaxhere e Zyrës. Gjatë më shumë se 12 viteve të saj në QKSS, përveç punës menaxheriale, ajo ka qenë e angazhuar gjerësisht edhe në hulumtim, me fokus kryesor në qeverisjen dhe integritetin në sektorin e mbrojtjes, si dhe në analizimin e sfidave të Kosovës në bashkëpunimin me BE-në në fushën e mbrojtjes dhe proceset e integritit në NATO. Tringa ka përfunduar studimet Executive MBA me specializim në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në University of Sheffield.

Mentor Vrajolli



Mentor Vrajolli është Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), me mbi shtatëmbëdhjetë vite përvojë në reformën e sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes, qeverisjen dhe bashkëpunimin rajonal. Ai iu bashkua QKSS-së në vitin 2008 si hulumtues, u bë Hulumtues i Lartë dhe Sekretar në vitin 2011, dhe që nga viti 2019 shërben si Drejtor Ekzekutiv. Vrajolli ka udhëhequr projekte mbi mbikëqyrjen e sigurisë, integrimin në NATO, marrëdhëniet civile-ushtarake, sigurinë kufitare dhe kundër-ekstremizmin e dhunshëm. Nga viti 2020 deri në 2024, ai ka shërbyer gjithashtu si Udhëheqës Ekipi për projektet Bilateral Support Kosovo në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, të zbatuara nga CIDS nën Ministrinë e Mbrojtjes së Norvegjisë. Që nga viti 2019, ai është anëtar i listës së ekspertëve të Global Initiative Against Transnational Organized Crime (GI-TOC).

© **Mohim i përgjegjës:** Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung. Ky botim i Konrad-Adenauer-Stiftung shërben vetëm për qëllime informative. Ai nuk mund të përdoret nga partitë politike ose nga aktivistët apo mbështetësit zgjedhorë për qëllime të reklamës zgjedhore.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
HYRJJE	8
I. EVOLUCIONI I SEKTORIT TË MBROJTJES TË BE-SË: POLITIKAT PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM	9
1.1. Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane dhe ReArm Europe	10
II. HARTËZIMI I INSTRUMENTEVE DHE INICIATIVAVE KYÇE EVROPIANE NË FUSHËN E MBROJTJES	12
2.1. Politika e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP)	12
2.2. Agjencia Evropiane e Mbrojtjes	13
2.3. Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar (PESCO)	15
2.4. Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDC)	15
2.5. Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF)	16
2.6. Instrumenti Evropian për Paqen (EPF)	17
2.7. Komiteti Ushtarak i BE-së (EUMC)	17
2.8. Baza Teknologjike dhe Industriale e Mbrojtjes Evropiane (EDTIB)	17
2.9. Programi për Industrinë e Mbrojtjes Evropiane (EDIP)	18
III. DINAMIKAT E BRENDSHME NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE BASHKËPUNIMI ME MEKANIZMAT E MBROJTJES TË BE-SË	19
3.1. Shqipëria	20
3.2. Mali i Zi	21
3.3. Maqedonia e Veriut	22
3.4. Serbia	22
3.5. Bosnjë dhe Hercegovina	23
3.6. Kosova	23
IV. ZHVILLIMI I SEKTORIT TË MBROJTJES NË KOSOVË DHE BASHKËPUNIMI I SAJ ME BE-NË	26
4.1. Pasqyra e Sektorit të Mbrojtjes në Kosovë	26
4.2. Përgjigja e Kosovës ndaj sfidave në rritje të sigurisë: mes veprimeve të nevojshme dhe shqetësimeve të BE-së nga përshkallëzimi	27
4.3. Përgjigja institucionale e Kosovës ndaj kërcënimeve në rritje të sigurisë: transformimi i sektorit të mbrojtjes	28
4.4. Pasqyra e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes	30
4.5. Pikat e hyrjes për rritje të bashkëpunimit Kosovë-BE në fushën e mbrojtjes	31
4.6. Strategjia me faza për bashkëpunim të zgjeruar	33
V. KONKLuzion DHE REKOMANDIMES	35

Përmbledhje ekzekutive

Rreshtimi i forcave të mbrojtjes të Bashkimit Evropian ka ndryshuar rrënjësisht prej fillimit të luftës për pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane – Gatishmëria 2030 dhe agjenda “ReArm Europe” të lansuar në mars të vitit 2025, janë sinjale të kalimit nga çështjet e lidhura me rritjen e bashkëpunimit tek rritja e gatishmërisë, zgjerimi i kapaciteteve industriale dhe prokurimi i përbashkët. Për Kosovën dhe mbarë rajonin, ky evolucion krijon mundësinë që të kthehet në partner praktik të sigurisë dhe të mos shihet më vetëm nga prizmi i stabilizimit dhe zgjerimit. BE-ja po bëhet gjithnjë e më shumë e vetëdijshme se reziliencia e vendeve fqinje me Evropën, përfshirë këtu edhe Ballkanin, varet nga mbyllja e hendekëve të kapaciteteve, përmirësimi i ndërveprueshmërisë dhe kufizimi i ndikimeve të jashtme keqdashëse. Veç kësaj, BE-së i duhet të ushtrojë ndikim në “oborrin e shtëpisë së vet” përpara se të marrë përsipër çfarëdo roli domethënës jashtë kontinentit. Në këto kohë të pështjellimeve globale, BE-ja duhet t’ia lehtësojë Ballkanit Perëndimor, si një të tërë, lidhjen e partneriteteve të drejtpërdrejta në mbrojtje dhe siguri, përtej mekanizmave ekzistues të lidhur me zgjerimin.

Përpara se të përqendrohemi në sfidat dhe mundësitë specifike të Kosovës për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes, punimi shqyrton instrumentet kryesore të BE-së në fushën e mbrojtjes që vlejné për rajonin, si dhe pozicionet aktuale të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Analiza konstaton se mjeti kryesor për angazhimin e Ballkanit Perëndimor me fushën e mbrojtjes së BE-së është Politika e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP), kryesisht përmes angazhimit dhe kontributeve në misione. Instrumenti më i qasshëm për mbështetjen e drejtpërdrejtë të kapaciteteve është Instrumenti Evropian për Paqen (EPF), i cili është kthyer në mjetin më praktik të BE-së për asistencë ndaj partnerëve. Për dallim, mbetet e vështirë qasja në Fondin Evropian për Mbrojtjen (EDF) dhe Programin Evropian për Industrinë e Mbrojtjes (EDIP), sepse shtetet e Ballkanit Perëndimor klasifikohen si vende të treta jo të asociuara. Parimisht, vendet e treta

mund të marrin pjesë në projektet e PESCO-s, por kjo pjesëmarrje është tepër e kufizuar dhe mbetet e paarrtshme për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndërmjet këtyre kategorive qëndron Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA): ajo mund të bashkëpunojë me shtetet jo anëtare të BE-së përmes aranzhimeve administrative, por aranzhime të tilla kërkojnë aprovim unanim nga ministrat e mbrojtjes të BE-së, duke e bërë bashkëpunimin politikisht sfidues edhe kur bashkëpunimi teknik do të ishte reciprokisht i dobishëm.

Punimi shqyrton thellësinë e bashkëpunimit të secilit vend të Ballkanit Perëndimor me BE-në në fushën e mbrojtjes, bashkëpunim i cili varet prej tre faktorëve: përafrimi strategjik me BE-në, kapaciteti institucional dhe konteksti më i gjerë politik, si brenda vendit ashtu edhe brenda BE-së. Shqipëria është shembull si përkthehen në angazhim më të thellë qëndrimi i qartë pro-perëndimor dhe institucionet e parashikueshme, duke përfshirë lidhjen e një Partneriteti për Sigurinë dhe Mbrojtjen (SDP) dhe mbështetjen përcjellëse përmes Instrumentit Evropian për Paqen (EPF). Mali i Zi ende shihet përgjithësisht si pararendës në procesin e anëtarësimit, por paqëndrueshmëria e vazhdueshme politike e brendshme bart riskun që ta ngadalësojë momentumin. Maqedonia e Veriut tregon si mund të kufizohet bashkëpunimi shkaku i kontesteve dypalëshe edhe pas anëtarësimit në NATO, pavarësisht se ka lidhur edhe SDP me BE-në. Bosnjë dhe Hercegovina mbetet strukturalisht e kufizuar nga fragmentimi i brendshëm dhe ngërçi kronik në qeverisje. Nga rasti i Serbisë mund të nxirren mësimet me vlerë: është i vetmi vend në rajon me një aranzhim formal administrativ me EDA-n (2013) dhe kapacitete të konsiderueshme industriale, megjithatë refuzimi i saj për t’u përafruar me politikën e jashtme të BE-së ndaj Rusisë dhe qëndrimi i saj destabilizues ndaj fqinjëve, veçanërisht Kosovës, minojnë besimin dhe kufizojnë vlerën strategjike të këtij bashkëpunimi¹. Kosova, për dallim, ka mbetur në margjinat e bashkëpunimit të BE-së në fushën e mbrojtjes, e kufizuar nga vazhdimi i mosnjohjes së shtetësisë së saj nga

¹Komisioni Evropian, “Dokument punues i personelit të Komisionit: Raporti për Serbinë 2024”, 30 tetor 2024, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/3c8c2d7f-bff7-44eb-b868-414730cc5902_en?filename=Serbia%20Report%202024.pdf

pesë shtete anëtare të BE-së dhe nga kontesti i pazgjidhur me Serbinë, ndërkohë që po rritet konsolidimi i sektorit të saj të mbrojtjes.

Duke u fokusuar në sfidat specifike të Kosovës, dokumenti thekson se sektori i saj i mbrojtjes është zhvilluar pothuajse ekskluzivisht përmes aranzhimeve mbështetëse të NATO-s dhe bashkëpunimit dypalësh me vendet aleate të NATO-s, duke shpjeguar se paralelisht, dhe për shkak se sektori i mbrojtjes ka mbetur në fazë konsolidimi, Kosova nuk ka ndërmarrë ende përpjekje të strukturuar për zgjerim të bashkëpunimit me BE-në në fushën e mbrojtjes. Gjithsesi, me zgjerimin e profilit të mbrojtjes të BE-së, edhe sektori i mbrojtjes në Kosovë ka hyrë në një fazë me ritëm të përshpejtuar. Prej marrjes së vendimit në vitin 2018 për shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forca të Armatosura (cak që duhet të arrihet deri në vitin 2028), Kosova i ka rritur ndjeshëm shpenzimet për mbrojtjen dhe i ka zgjeruar ambicet për kapacitete si kundërpërgjigje ndaj përkeqësimit të mjedisit të sigurisë. Me afrimin e momentit historik të vitit 2028, detyrat më të ngutshme janë konsolidimi i zhvillimit të forcave në mënyrë të qëndrueshme, miratimi i kornizave ligjore dhe rregullatore që mungojnë, si dhe investimet për zhvillimin e industrisë së mbrojtjes, në mënyrë që iniciativa të tilla si prodhimi i municioneve dhe zona e industrisë së mbrojtjes të arrijnë të sigurojnë mbështetje të besueshme dhe llogaridhënese për kapacitetet.

Punimi thekson se zhvillimi i sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë është vënë në lëvizje edhe nga një mjedis më sfidues dhe kërcënues. Në veçanti, ky zhvillim formësohet nga mosnjohja e vazhdueshme e Serbisë dhe kapaciteti i saj i demonstruar për të mundësuar përshkallëzim të dhunshëm, përfshirë strukturat e lidhura me Beogradin në veri të Kosovës. Sulmi terrorist i vitit 2023 në Banjaskë, incidentet pasuese të sigurisë dhe modeli më i gjerë i trysnisë kundër institucioneve të Kosovës nënvizojnë se risku kryesor nuk vjen vetëm nga çekuilibri konvencional ushtarak, por edhe nga një përzierje e mjeteve shtrënguese, sabotimeve, dezinformimit dhe mobilizimit të akterëve vegël (proxy). Lufta e Ruisë kundër Ukrainës e përforcon më tej këtë risk duke krijuar stimuj për Moskën që të inkurajojë dinamikën e krizës në Ballkan në mënyrë që të tërhiqet vëmendja perëndimore dhe të dobësohet kohezioni euroatlantik.

Zbutja e këtyre kërcënimeve kërkon një qasje të dyfishtë. Për Kosovën është legjitime nevoja për ngritjen e besueshmërisë së aftësive frenuese dhe të reziliencës përmes zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe kohezionit të brendshëm; megjithatë, marrë parasysh kontekstin e saj unik politik, Kosovës i duhet gjithashtu koordinimi i ngushtë dhe komunikimi konsistent me BE-në dhe aleatët e tjerë perëndimorë që kanë qenë sponsorët kryesorë të shtetësisë së Kosovës. Nga ana e tyre, BE-ja dhe partnerët e saj perëndimorë duhet ta trajtojnë Kosovën si pjesë të sigurisë së fqinjësisë së tyre, duke e kombinuar diplomacinë me mesazhe frenuese më konsistente, mbështetje më të fortë për sundimin e ligjit dhe kapacitetet kundër luftës hibride, si dhe me bashkëpunim praktik në fushën e mbrojtjes që e redukton izolimin e Kosovës.

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ndërmjet Kosovës dhe BE-së deri më tani ka qenë i kufizuar dhe kryesisht i tërthortë, i formësuar nga ndarja e roleve pas vitit 2008, me NATO-n që ka qenë bartëse kryesore e zhvillimit të FSK-së dhe BE-në të fokusuar në sundimin e ligjit përmes EULEX-it dhe me qëndrim neutral ndaj statusit. Gjithsesi, rritja e BE-së si akter më i fortë në fushën e mbrojtjes e bën këtë ndarje gjithnjë e më të vjetëruar. Nisur nga bashkëpunimi ekzistues ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara, ku përfshihet edhe dislokimi i mundshëm në Gaza si pjesë e misionit paqeruajtës, ekziston një bazë e fortë për t'u mbështetur në kompromisin e bashkëpunimit të mundshëm ndërmjet BE-së dhe Kosovës në fushën e mbrojtjes. Punimi identifikon pikat praktike të hyrjes që mund të funksionojnë edhe nën kufizime politike:

- > të synohet një Partneritet Kosovë-BE për Siguri dhe Mbrojtje si portë qendrore politike, në përputhje me modelin e përdorur për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut;
- > të bëhen përgatitje për kontribute në misionet e CSDP-së për të demonstruar tranzicionin e Kosovës nga konsumatori i sigurisë në ofrues sigurie;
- > të kërkohet angazhim i strukturuar me Kolegjin Evropian të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDC) për ngritjen e kapitalit njerëzor dhe ndërveprueshmërinë përmes trajnimit dhe edukimit;
- > të ndiqet një bashkëpunim gradual me EDA-n, duke filluar me konsultime teknike dhe

bashkëpunim specifik në fusha të ndryshme (veçanërisht mbrojtja kibernetike, mbështetja mjekësore, veprimi ndaj minave, standardet dhe trajnimi) në vend të një aranzhimi gjithëpërfshirës të menjëhershëm; dhe

- > të thellohet bashkëpunimi dypalësh në fushën e mbrojtjes me shtetet njohëse anëtare të BE-së për ngritjen e kapaciteteve dhe kultivimin e një koalicioni të mbështetëse politikë brenda sistemit të BE-së.

Punimi identifikon edhe një listë të veprimeve prioritare afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për institucionet e Kosovës:

PLANI AFATSHKURTËR (2026–2027): të lansohet një rrugë diplomatike e dedikuar për një Partneritet me BE-në për Sigurinë dhe Mbrojtjen; të zgjerohen marrëveshjet dypalëshe të mbrojtjes dhe trajnimi i përbashkët me shtetet kyçe njohëse anëtare të BE-së; të lansohen konsultime teknike me EDA-n në fusha me ndjeshmëri të ulët; të sigurohet qasje sistematike në kurset e ESDC-së; të miratohet legjislacioni që rregullon industrinë e mbrojtjes; të aprovohet lokacioni për parkun e zonës së industrisë së mbrojtjes dhe të sigurohen fondet për ndërtimin e tij;

PLANI AFATMESËM (2028–2030): të arrihet momenti historik i shndërrimit në vitin 2028 duke siguruar qëndrueshmëri në zhvillimin e trupave, trajnimeve dhe pajisjeve; të sigurohet gatishmëri operationale për të paktën një kontribut të specializuar në një mision të CSDP-së (ose një dislokim ekuivalent ndërkombëtar); të funksionalizohet zona e industrisë së mbrojtjes dhe të fillojë prodhimi me standarde të NATO-s dhe masa mbrojtëse të fuqishme për pajtueshmërinë dhe kontrollin e eksporteve; të thellohet bashkëpunimi funksional me EDA-n në drejtime të

përzgjedhura të punës duke krijuar standarde të ndërveprueshmërisë me partnerët e BE-së.

PLANI AFATGJATË (2030-2035): të synohet bashkëpunim i institucionalizuar me EDA-n (ose një aranzhim ekuivalent) pasi ta lejojnë kushtet politike; të integrohen firma të zgjedhura të Kosovës në zinxhirët e furnizimit të përafuar me BE-në përmes certifikimit, standardeve dhe rrugëve për lejen e sigurisë; të konsolidohet roli i Kosovës si kontribuese neto e sigurisë përmes pjesëmarrjes së rregullt në stërvitje dhe dislokime shumëkombëshe.

Rekomandimi gjithëpërfshirës është që konsolidimi i mbrojtjes së Kosovës dhe bashkëpunimi Kosovë-BE në fushën e mbrojtjes të trajtohen si përforcues të njëri-tjetrit. Për Kosovën, prioriteti i menjëhershëm është kombinimi i zhvillimit të përshpejtuar të kapaciteteve me besueshmërinë institucionale – prokurimet transparente, mbikëqyrjen e fortë, edukimin profesional dhe bazën e qartë ligjore për çdo zgjerim të industrisë së mbrojtjes. Për BE-në, prioriteti është konsistenca strategjike: të ruhet qasja neutrale ndaj statusit nëse këmbëngulin shtetet anëtarë mosnjohëse, por të zgjerohet bashkëpunimi funksional në fushën e mbrojtjes aty ku është e mundur, duke përdorur SDP-të, asistencën e llojit të EPF-së, trajnimet dhe bashkëpunimin teknik për ta reduktuar izolimin e Kosovës dhe për ta forcuar aftësinë frenuese rajonale. Në këtë mjedis sigurie ku mbeten të mundshme përshkallëzimi i lidhur me Serbinë dhe presioni hibrid i mundësuar nga Rusia, përjashtimi i Kosovës nga mekanizmat evropianë të mbrojtjes në zhvillim nuk është vetëm problem i Kosovës, por cenueshmëri për sigurinë e fqinjësisë së BE-së. Një strategji angazhimi në faza dhe e kalibruar politikisht ofron një rrugë realiste për mbylljen e këtij hendeku.



Hyrje

Peizazhi i politikës së mbrojtjes të Bashkimit Evropian ka pësuar një transformim dramatik që nga nisja e luftës nga Rusia për pushtimin e Ukrainës në shkurt 2022, e cila ka sjellë atë që Këshilli Evropian e quajti një 'ndryshim tektonik në historinë evropiane'² që e riformoi rrënjësisht qasjen e kontinentit ndaj sigurisë dhe mbrojtjes. Ky ndryshim gjeopolitik përshpejtoi transformimet e iniciuara nga Strategjia Globale e BE-së e vitit 2016, e cila avokonte për 'autonomi strategjike'.³ Gjithsesi, në kontekstin aktual qasja është bërë dukshëm më e vendosur për shkak të shqetësimeve të mirëfillta për sigurinë evropiane. Kështu, vetëm disa javë pasi Rusia filloi luftën për pushtimin e Ukrainës, BE-ja miratoi **Busullën Strategjike për Sigurinë dhe Mbrojtjen**, një plan ambicioz veprimi që synonte përmirësimin e Politikës së BE-së për Sigurinë dhe Mbrojtjen.⁴ Kështu u udhëhoq me sukses integrimi fillestar i sigurisë dhe prokurimi i përbashkët i bllokut përpara se të vazhdohej me Librin e Bardhë për Mbrojtjen Evropiane dhe Planin ReArm Europe (Gatishmëria 2030) në mars 2025.

Plani i fundit ReArm Europe është veprimi më ambicioz deri më sot që rezulton në zotime të paprecedentë për gatishmërinë e mbrojtjes, duke mobilizuar mbi 800 miliardë euro për të forcuar infrastrukturën e mbrojtjes dhe bazën industriale të Evropës.⁵ Për Ballkanin Perëndimor, ky ndryshim strategjik paraqet mundësi dhe sfida, pasi që gjashtë vendet e rajonit – Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – gjenden në faza të ndryshme të integritimit në mekanizmat e mbrojtjes të BE-së, veçanërisht bashkëpunimin me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes (EDA).

Ky punim analizon transformimin e shpejtë të sektorit të mbrojtjes të BE-së dhe eksploron mundësitë në rritje për bashkëpunim substancial ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, me theks të veçantë tek Kosova. Synimi i punimit

është t'u jepet përgjigje disa pyetjeve kyçe të hulumtimit: Si ka ndryshuar politika e mbrojtjes dhe mekanizmat e bashkëpunimit të BE-së që nga viti 2016 dhe në çfarë mënyrash është përshpejtuar ky proces që nga viti 2022? Cilat janë qëllimet dhe mjetet e përshkruara në Librin e Bardhë për Mbrojtjen Evropiane dhe iniciativën ReArm Europe? Si e lehtëson BE-ja bashkëpunimin me vendet jo-anëtare të BE-së, siç janë ato në Ballkanin Perëndimor dhe veçanërisht me Kosovën, përmes Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes dhe mekanizmave të tjerë? Çfarë precedentësh ekzistojnë për angazhimin e Ballkanit Perëndimor me strukturat e mbrojtjes të BE-së? Më e rëndësishmja, cilat rrugë realiste dhe ligjërishite ose politikisht të mundshme janë në dispozicion për Kosovën, marrë parasysh që nuk ka as status të shtetit anëtar dhe as status të shtetit kandidat të BE-së dhe kufizimet që rezultojnë nga mosnjohja?

Kjo analizë shqyrton dokumentet e politikave të BE-së, konkluzionet e Këshillit, kornizat e EDA-s, dokumentet strategjike, literaturën akademike dhe intervistat e ekspertëve me zyrtarë nga Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Mbrojtjes të Kosovës (shkurt 2026). Punimi është i strukturuar sipas 4 seksione kryesore. Seksioni i parë analizon kontekstin e përgjithshëm të transformimit të sektorit të mbrojtjes të BE-së, me fokus të veçantë nga viti 2016 deri më sot. Seksioni i dytë ofron një hartëzim të shpejtë të instrumenteve dhe iniciativave kyçe BE-së në fushën e mbrojtjes dhe nëse vendet e Ballkanit Perëndimor kanë qasje në to apo jo. Seksioni i tretë analizon pozicionin e secilit vend të Ballkanit Perëndimor në lidhje me bashkëpunimin me BE-në në fushën e mbrojtjes. Seksioni i katërt fokusohet tek Kosova, duke analizuar kontekstin specifik të zhvillimit të sektorit të mbrojtjes dhe gjendjen aktuale në këtë sektor, pozicionin aktual, si dhe duke identifikuar opsione konkrete të politikave për bashkëpunim të zgjeruar me EDA-n dhe mekanizmat më të gjerë të mbrojtjes të BE-së.

2 Këshilli Evropian, Deklarata e Versajës, 10–11 mars 2022, <https://www.consilium.europa.eu/media/54773/20220311-versailles-declaration-en.pdf>.

3 Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS), Vizion i përbashkët, veprim i përbashkët: një Evropë më e fortë – një Strategji Globale për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian, qershor 2016, https://www.eeas.europa.eu/eeas/global-strategy-european-unions-foreign-and-security-policy_en

4 Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS) (2022) Një busull strategjike për sigurinë dhe mbrojtjen. Në dispozicion në: https://www.eeas.europa.eu/eeas/strategic-compass-security-and-defence-1_en

5 Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane – Gatishmëria 2030, 19 mars 2025, https://defence-industry-space.ec.europa.eu/eu-defence-industry/white-paper-european-defence-readiness-2030_en

I. Evolucioni i sektorit të mbrojtjes të BE-së: Politikat për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Bashkimi Evropian ia nisi t'i zhvillojë mekanizmat e veta të sigurisë dhe mbrojtjes në fillim të viteve 2000, i nxitur nga aftësia e tij e kufizuar për t'i menaxhuar krizat në mënyrë të pavarur gjatë konflikteve ballkanike të viteve 1990. Përparimi mbeti gradual për shumë vite, pasi që shumë shtete anëtare të BE-së, gjithashtu anëtare të NATO-s, vazhdimisht prioritozonin Aleancën Atlantike si strukturën e tyre kryesore të sigurisë. Këto shtete e kundërshtonin zhvillimin përmbajtësor të kapaciteteve të forcave të mbrojtjes të BE-së, nga frika se mund të rivalizonte rolin e NATO-s në sigurinë evropiane. Ky qëndrim pasqyron si garantitë ushtarake të ofruara nga Shtetet e Bashkuara përmes NATO-s ashtu edhe shqetësimet se dyfishimi i strukturave të mbrojtjes do të çonte në shpërdorim të resurseve dhe do t'i komplikonte aranzhimet e komandës.⁶

Përkundër këtyre rezervave, BE-ja bëri përparime të dukshme gjatë viteve 2000. Momentet kyçe historike përfshinin krijimin e Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes (EDA) në 2004, Kolegjit Evropian të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDC) në 2005 dhe konsolidimin e Politikës së Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP) në 2009. Më pas, Strategjia Globale e BE-së e vitit 2016 ofroi një kornizë strategjike, duke çuar në lansimin e Bashkëpunimit të Përhershëm të Strukturuar (PESCO) dhe Shqyrtimit Vjetor të Koordinuar për Mbrojtjen (CARD) në vitin 2017. Për më tepër, kjo çoi edhe në krijimin e Fondit Evropian për Mbrojtjen (EDF) dhe Instrumentit Evropian për Paqen (EPF) në vitin 2021.

Gjithsesi, pika vendimtare e kthesës erdhi pas fillimit të luftës nga Rusia për pushtimin e Ukrainës në shkurt 2022. Kjo ngjarje, e cilësuar nga Përfaqësuesi i Lartë Josep Borrell si një "moment

zgjimi për Evropën", shkaktoi një transformim të shpejtë në Politikën e BE-së për Mbrojtjen.⁷ Lufta ekspozoi hendekët kritike në kapacitetet e forcave të mbrojtjes dhe kapacitetet industriale evropiane, duke vënë në pah investimet e pamjaftueshme për vite të tëra dhe duke nxitur thirrje urgjente për gatishmëri kolektive. Si kundërpërgjigje të drejtpërdrejtë, BE-ja miratoi Busullën Strategjike për Mbrojtjen dhe Sigurinë në vitin 2022, vetëm disa javë pas luftës pushtuese të Ruisë. Ky dokument përvijoi synimin e BE-së për të zhvilluar kapacitete gjithëpërfshirëse dhe për të forcuar Bazën Teknologjike dhe Industriale të Mbrojtjes Evropiane (EDTIB). Megjithatë, kjo nuk e zvogëloi presionin nga Shtetet e Bashkuara mbi aleatët evropianë për të rritur shpenzimet e mbrojtjes dhe për të marrë përgjegjësi më të madhe për t'i frenuar kërcënimet ruse, duke përforcuar nevojën për të shkuar përtej standardit të NATO-s prej 2 për qind të BPV-së. Në Samitin e NATO-s të vitit 2025, administrata e SHBA-së u bëri thirrje aleatëve të zotohen për t'i rritur shpenzimet e mbrojtjes në 5 për qind të BPV-së; ndërkohë që Spanja e kundërshtoi hapur, pjesa tjetër e aleatëve evropianë përfundimisht e mbështetën cakun e ri përkundër ndjeshmërive të ndryshme kombëtare.⁸ Ky presion i SHBA-së dhe perceptimi i shtuar i kërcënimit e shtynë BE-në të kalojë nga bashkëpunimi gradual dhe i specializuar drejt iniciativave gjithëpërfshirëse të mbrojtjes me resurse financiare të padëshmuara, të cilat kulmuan në mars 2025 me Librin e Bardhë për Gatishmërinë Evropiane të Mbrojtjes 2030 që shërben si shtylla kurrizore strategjike për Planin prej 800 miliardë eurosh "ReArm Europe" të dedikuar për rritjen e Bazës Teknologjike dhe Industriale të Mbrojtjes Evropiane (EDTIB). Më poshtë do të analizohet në detaje Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane – Gatishmëria 2030 dhe Plani ReArm Europe.

⁶ Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Marrëdhëniet me Bashkimin Evropian (pa datë). Përditësimi i fundit 20 qershor 2025, <https://www.nato.int/en/what-we-do/partnerships-and-cooperation/relations-with-the-european-union>

⁷ Josep Borrell, Evropa në Interregnum: Zgjimi ynë gjeopolitik pas Ukrainës, Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS), 24 mars 2022, https://www.eeas.europa.eu/eeas/europe-interregnum-our-geopolitical-awakening-after-ukraine_en

⁸ CNBC, "Aleatët e NATO-s dakordohen për cak më të lartë të shpenzimeve të mbrojtjes prej 5%", CNBC, 25 qershor 2025, <https://www.cnbcc.com/2025/06/25/nato-allies-agree-to-higher-5percent-defense-spending-target.html>

1.1. Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane dhe ReArm Europe

Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane – Gatishmëria 2030, i prezantuar bashkërisht nga Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesja e Lartë Kaja Kallas më 19 mars 2025, përfaqëson artikullimin më ambicioz të strategjisë së BE-së për mbrojtjen që nga lindja e kësaj politike.⁹ Dokumenti hapet me një vlerësim pa mëdyshje: ‘Evropa po përballlet me një kërcënim akut dhe në rritje. E vetmja mënyrë që mund të sigurojmë paqen është të kemi gatishmërinë t’i frenuar ata që do të na bënin dëm’.¹⁰ Kjo kornizë pasqyron një ndryshim rrënjësor nga theksi tradicional i BE-së në fuqinë e butë dhe parandalimin e konflikteve drejt pranimit të domosdoshmërive të vështira të sigurisë të nxitura nga lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, forcimi ushtarak i Kinës dhe sjellja e saj dominuese brenda rajonit të vet, si dhe pasiguritë në lidhje me përkushtimin afatgjatë të Shteteve të Bashkuara për sigurinë evropiane.

Libri i Bardhë identifikon tranzicionin e Rusisë në ekonomi lufte totale – me 40 për qind të buxhetit të saj federal të drejtuar drejt shpenzimeve ushtarake – dhe përdorimin e vazhdueshëm të kërcënimeve bërthamore dhe strategjive hibride si kërcënimin kryesor akut për sigurinë evropiane, ndërsa Kinën e karakterizon si sfidë sistemike afatgjatë për shkak të fshehtësisë që rrethon rritjen e saj ushtarake, përparimeve të shpejta në kapacitete kibernetike dhe hapësirë, si dhe sjelljes së saj shtrënguese në Indo-Paqësor.

Objektivat themelore strategjike të artikuluar në Librin e Bardhë përfshijnë si prioritetet e

menjëhershme ashtu edhe ato afatgjata. Në planin afatshkurtër, fokusi përqendrohet në mbështetjen e Ukrainës përmes ndihmës së qëndrueshme ushtarake, duke përfshirë furnizimin vjetor me 2 milionë predha artilerie, sisteme të mbrojtjes ajrore dhe raketa, dhe vazhdimin e programeve të trajnimit dhe rigjenerimit të pajisjeve. Njëkohësisht, dokumenti kërkon nga BE-ja të mbyllë urgjentisht hendekët kritikë të kapaciteteve në fusha të tilla si mbrojtja raketore, sistemet e dronëve, prodhimi i municioneve të artillerisë dhe siguria kibernetike – fusha ku kapaciteti evropian ka rezultuar i pamjaftueshëm në raport me shkallën dhe intensitetin e kërcënimeve bashkëkohore.

Objektivat afatmesme theksojnë ngritjen e një tregu të mirëfilltë të BE-së për mbrojtjen që redukton fragmentimin, eliminon ‘anshmëritë kombëtare’ në prokurim që historikisht kanë çuar në sisteme të duplikuara dhe të papajtueshme, si dhe krijon ekonomi të shkallës që rrisin eficiencën dhe konkurrueshmërinë industriale. Prioritetet afatgjata fokusohen në përgatitjen e mbrojtjes së të nesërme përmes inovacionit trazues në teknologjitë në zhvillim, duke përfshirë inteligjencën artificiale, komputimin kuantik, sistemet autonome dhe kapacitetet e bazuara në hapësirë.

Nga ana tjetër, Plani ReArm Europe ofron arkitekturën financiare për zbatimin e objektivave të Librit të Bardhë, duke mobilizuar më shumë se 800 miliardë euro përmes mekanizmave të shumtë plotësues¹¹, si:

9 Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Libri i Bardhë i Përbashkët për Gatishmërinë Evropiane të Mbrojtjes 2030, njoftim për shtyp i EDA-s, 19 mars 2025, <https://eda.europa.eu/news-and-events/news/2025/03/19/joint-white-paper-for-european-defence-readiness-2030>

10 Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesja e Lartë i Unionit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane – Gatishmëria 2030, Bruksel, 19 mars 2025, https://commission.europa.eu/document/download/e6d5db69-e0ab-4bec-9dc0-3867b4373019_en?filename=White%20paper%20for%20European%20defence%20E2%80%93%20Readiness%202030.pdf

11 Shërbimi Parlamentar Evropian për Hulumtime (EPRS), Mbrojtja e BE-së: Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane – Gatishmëria 2030, Informatë, Parlamenti Evropian, 2025, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2025/769566/EPRS_BRI\(2025\)769566_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2025/769566/EPRS_BRI(2025)769566_EN.pdf)

KOMPONENTI I INICIATIVËS	MEKANIZMI I FINANCIMIT	SHKALLA	OBJEKTIVAT PARËSORE
Instrumenti i Veprimit të Sigurisë për Evropën (SAFE)	Kreditë e marra në tregjet e kapitalit	150 miliardë euro	Prokurimi i përbashkët ushtarak që përfshin të paktën dy vende; fondet e disbursuara për shtetet anëtare bazuar në planet kombëtare të investimeve në mbrojtje
Klauzola deroguese kombëtare	Fleksibiliteti buxhetor në kuadër të Paktit për Stabilitet dhe Rritje	650 miliardë euro për katër vjet	U lejon shteteve anëtare të rrisin shpenzimet e mbrojtjes pa shkelur rregullat fiskale të BE-së
Investimet e BEI në Mbrojtje	Financimi i Bankës Evropiane të Investimeve	2 miliardë euro në vit (dyfishuar)	Fokusi në dronë, teknologji kuantike dhe siguri kibernetike
Mobilizimi total	Mekanizmat e kombinuar	më shumë se 800 miliardë euro	Zhvillimi gjithëpërfshirës i infrastrukturës dhe kapaciteteve të mbrojtjes

Libri i Bardhë dhe Plani ReArm Europe ofrojnë mundësi të reja për integrimin e zinxhirëve evropianë të vlerës dhe bashkëpunimit. Ai thekson nevojën e ngutshme për bashkëpunim mbarë-evropian për të adresuar hendekët e mbrojtjes, duke vënë në dukje rolin e vazhdueshëm destabilizues të Rusisë në rajone ku përfshihen Ballkani Perëndimor, Gjeorgjia, Moldavia, Armenia dhe Afrika.¹² Teknikisht, ky është një tregues i qartë se dokumenti e pranon rëndësinë strategjike të Ballkanit Perëndimor dhe ofron një

politikë të dyerve të hapura për vendet e këtij rajoni.¹³ Gjithsesi, rezultatet praktike do të varen domosdoshmërisht nga përafrimi i rajonit me vlerat e BE-së në fushën e mbrojtjes, fuqia institucionale dhe faktorët politikë – veçanërisht skepticizmi nga disa anëtarë të BE-së. Në rastin e Kosovës do të jetë veçanërisht i rëndësishëm qëndrimi i pesë shteteve anëtarë të BE-së që nuk e njohin, përkundër përafrimit të fortë të Kosovës me BE-në dhe përrëndimin.

12 Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Libri i Bardhë për Mbrojtjen Evropiane – Gatishmëria 2030, Komisioni Evropian, 19 mars 2025, https://defence-industry-space.ec.europa.eu/eu-defence-industry/white-paper-european-defence-readiness-2030_en

13 Po aty

II. Hartëzimi i Instrumenteve dhe Iniciativave Kyçe Evropiane në Fushën e Mbrojtjes

Siç kanë ndryshuar me kalimin e kohës politikat e BE-së për mbrojtjen, po ashtu kanë evoluuar edhe instrumentet dhe iniciativat e BE-së, me Politikën e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP) që funksionon si korniza kryesore për koordinimin, menaxhimin e krizave dhe përpjekjet paqeruajtëse. Misionet civile dhe ushtarake të kryera në kuadër të CSDP-së kanë kontribuar në stabilizimin e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, si dhe kanë lehtësuar përgatitjet e vendeve për integrim në strukturat e sigurisë së BE-së. Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA) është vendimtare për rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, koordinimin e proceseve të prokurimit dhe promovimin e inovacionit; aranzhimet e saj administrative, si ato të vendosura me Serbinë, shërbejnë si platformë potencialisht e avancuar bashkëpunimi edhe për shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, edhe pse sfidat politike vazhdojnë të kufizojnë qasjen për partnerë shtesë.

Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar (PESCO) lejon integrim më gjithëpërfshirës dhe ligjërisht të detyrueshëm mes shteteve anëtare të BE-së në fushën e mbrojtjes, por ka paraparë pjesëmarrje të kufizuar të vendeve të treta; megjithatë, vendet e Ballkanit Perëndimor ende nuk i janë bashkuar. Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDC) ofron trajnime për CSDP-në, me bashkëpunimin më të dukshëm që përfshin Serbinë dhe Shqipërinë, ndërsa angazhimi me Kosovën mbetet i kufizuar për shkak të problemeve me njohjen.

Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF) mbështet hulumtimet dhe zhvillimin e përbashkët të kapaciteteve, por vendet e Ballkanit Perëndimor aktualisht janë të përjashtuara nga marrja e fondeve të BE-së, duke e kufizuar përfshirjen e tyre. Instrumenti Evropian për Paqen (EPF) shërben si mjeti parësor për bashkëpunim praktik, duke ofruar asistencë esenciale ushtarake aty ku mekanizmat e tjerë financiarë janë më pak të qasshëm, siç ilustron nga mbështetja e drejtpërdrejtë e ofruar për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Më poshtë do të jepet një analizë për secilin prej këtyre mekanizmave të BE-së. Siç do të shihet në sesionet e mëposhtme, CSDP, EDA dhe EPF përbëjnë kanalet më të drejtpërdrejta dhe më të adaptueshme për përfshirjen e Ballkanit Perëndimor, ndërsa PESCO, EDF dhe ESDC paraqesin pengesa më të mëdha për shkak të kufizimeve politike dhe të pranueshmërisë. Aranzhimet administrative të EDA-s dhe mekanizmat mbështetës të EPF-së ofrojnë mundësi të rëndësishme për të avancuar bashkëpunimin BE-Balkan Perëndimor në fushën e mbrojtjes. Synimi i kësaj analize hartëzimi është t'i informojë politikëbërësit në Kosovë dhe rajon rreth fushëveprimit të secilit prej këtyre mekanizmave dhe të vërë në pah rrugët e mundshme për angazhim.

2.1. Politika e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP)

Politika e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP) është korniza kryesore e Bashkimit Evropian për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimin e krizave, e lansuar zyrtarisht në

vitin 1999 si ESDP dhe e riemëruar nga Traktati i Lisbonës i vitit 2009. E fokusuar fillimisht në menaxhimin e krizave dhe ruajtjen e paqes – të njohura si detyrat e Petersberg-ut,¹⁴ CSDP-ja ka

¹⁴ Detyrat e Petersberg-ut (siç përcaktohen në Deklaratën e Petersberg-ut), të miratuara më 19 qershor 1992 dhe më vonë të përfshira në Politikën e

evoluar në një mjet për autonomi strategjike dhe integrim më të thellë në fushën e mbrojtjes, sidomos pas Strategjisë Globale të BE-së (2016) dhe Busullës Strategjike (2022).

Sot, CSDP-ja mbikëqyr misionet civile dhe operacionet ushtarake jashtë kontinentit, ndërkohë që i udhëheq shtetet anëtare drejt planifikimit të harmonizuar të mbrojtjes dhe reduktimit të prokurimit të fragmentuar. Vendimet merren në nivel ndërqeveritar: Këshilli Evropian përcakton prioritetet, Këshilli i Punëve të Jashtme i zbaton ato, si dhe kërkohet unanimitet, me përjashtim të fushave të caktuara si Agjencia Evropiane e Mbrojtjes dhe PESCO.

Përfaqësuesi i Lartë koordinon veprimet e CSDP-së, drejton EEAS-in dhe EDA-n, si dhe e përfaqëson BE-në në rrafshin e jashtëm.¹⁵ Komiteti Politik dhe i Sigurisë drejton operacionet për menaxhim të krizave. Janë disa mekanizma që e mbështesin CSDP-në. Ky është rezultat i zgjerimit të CSDP-së duke futur gradualisht mekanizma të rinj si Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (2004), Bashkëpunimi i

Përhershëm i Strukturuar (2017) dhe Shqyrtimi Vjetor i Koordinuar për Mbrojtjen (CARD), i cili monitoron shpenzimet e shteteve për mbrojtjen dhe identifikon hendekët. Instrumenti Evropian për Paqen (2021) kontribuon edhe duke mbuluar kostot e përbashkëta të operacioneve ushtarake të CSDP-së dhe duke i furnizuar vendet partnere me pajisje.

CSDP-ja është korniza kryesore e BE-së për promovimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor. Përmes misioneve si EUFOR Althea dhe EULEX, CSDP-ja ka kontribuar drejtpërdrejt në sigurinë dhe sundimin e ligjit në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë përkatësisht. CSDP-ja angazhohet në mënyrë aktive me vendet candidate për të marrë pjesë në operacionet e BE-së dhe për të kaluar nga konsumatorë të sigurisë në ofrues të saj. CSDP-ja gjithashtu mbështet përgjigje të koordinuara ndaj kërcënimeve hibride dhe sigurisë kibernetike, duke ndërtuar një kulturë të përbashkët strategjike për ta përgatitur rajonin për integrim në strukturat evropiane të sigurisë.

2.2. Agjencia Evropiane e Mbrojtjes

Agjencia Evropiane e Mbrojtjes u themelua më 12 korrik 2004 përmes Veprimit të Përbashkët 2004/551/CFSP të Këshillit, duke u bërë funksionale si agjencia e BE-së për bashkëpunim për armatime.¹⁶ EDA rrodhi nga pranimi se prokurimi i fragmentuar për forcat e mbrojtjes kombëtare po krijonte duplikime, probleme ndërveprueshmërie dhe shpenzime joefikase në të gjithë forcat e armatosura evropiane.¹⁷ Mandati i saj fillestar u përqendrua në katër funksione kyçe: zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes për të përmbushur kërkesat operacionale të CSDP-së, promovimi dhe përmirësimi i bashkëpunimit evropian për armatime, forcimi i Bazës Teknologjike dhe Industriale të Mbrojtjes Evropiane (EDTIB) dhe mbështetja e hulumtimeve dhe teknologjisë

në fushën e mbrojtjes. Agjencia funksionon nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë, me pjesëmarrjen e të 27 shteteve anëtare të BE-së (Danimarka fillimisht u tërhoq, por iu bashkua në vitin 2024).¹⁸ Bordi Drejtues i EDA-s, i përbërë nga ministri e mbrojtjes, ofron udhëzime strategjike dhe aprovon programin e punës dhe buxhetin e Agjencisë.

Në maj 2024, ministri e mbrojtjes të BE-së miratuan Shqyrtimin Afatgjatë të EDA-s, duke zgjeruar detyrat themelore nga tri në pesë fusha: mbështetja e ciklit të plotë të zhvillimit të kapaciteteve, agregimi i kërkesave për prokurim të përbashkët, mundësimi i hulumtimeve dhe inovacionit bashkëpunues në fushën e mbrojtjes,

Përbashkët të BE-së për Sigurinë dhe Mbrojtjen, përmbledhje e EURLex, https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:petersberg_tasks

¹⁵ Këshilli i Bashkimit Evropian, Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Consilium (Këshilli i BE-së), qasur në shkurt 2026, <https://www.consilium.europa.eu/en/council-eu/high-representative-foreign-affairs-security-policy/>

¹⁶ Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Agjencia Evropiane e Mbrojtjes - ueb faqja zyrtare, Bashkimi Evropian, qasur në shkurt 2026, <https://eda.europa.eu/?lang=en>

¹⁷ Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF), EDA - Iniciativat e BE-së në fushën e mbrojtjes, Bashkimi Evropian, qasur në shkurt 2026, <https://eda.europa.eu/what-we-do/EU-defence-initiatives/european-defence-fund-%28edf%29>

¹⁸ Industria e Mbrojtjes në Evropë, Danimarka i bashkohet Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes, Industria e Mbrojtjes në Evropë, 25 mars 2023, <https://defence-industry.eu/denmark-joins-the-european-defence-agency>

shprehja e qëndrimeve të përbashkëta të shteteve anëtare në nivel të BE-së dhe sigurimi i përafrimit koherent të iniciativave të BE-së në fushën e mbrojtjes.¹⁹ Ky mandat i përfunduar pasqyron mjedisin e përkeqësuar të sigurisë pas pushtimit rus të Ukrainës dhe e pozicionon EDA-n si akter më strategjik në koordinimin e përpjekjeve evropiane të mbrojtjes.

EDA luan role kryesore të zbatimit dhe mbështetjes në të gjitha iniciativat kryesore të BE-së në fushën e mbrojtjes. Për Planin për Zhvillim të Kapaciteteve, Agjencia koordinohet me shtetet anëtare për të identifikuar fushat prioritare të kapaciteteve dhe rrugët zhvillimore. Si organi parësor zbatues për Shqyrtimin Vjetor të Koordinuar për Mbrojtjen (CARD), EDA analizon planifikimin dhe shpenzimet e mbrojtjes kombëtare për të identifikuar mundësitë për bashkëpunimin dhe për të reduktuar investimet e duplikuara.²⁰ Agjencia kryen funksione sekretariate për Bashkëpunim të Përhershëm të Strukturuar së bashku me Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm, duke lehtësuar zhvillimin e projekteve dhe monitorimin e zotimeve detyruese. Teksa Fondi Evropian për Mbrojtjen menaxhohet nga Komisioni Evropian, EDA ofron ekspertizë

teknike dhe ndihmon në përafrimin e projekteve të financuara nga EDF-ja me kërkesat operationale të identifikuar nga ministrinë e mbrojtjes. Qendra për Inovacionin e Mbrojtjes Evropiane (HEDI) e themeluar së fundmi lidh inovacionet afatshkurtra me përdoruesit fundorë ushtarakë, duke përshpejtuar rrugën nga koncepti në dislokimin operacional.²¹

EDA bashkëpunon në mënyrë aktive me vendet jo anëtare të BE-së përmes aranzhimeve dypalëshe administrative të strukturuar me kujdes, të cilat lidhen nën autoritetin e shteteve anëtare pas vlerësimit të përfitimeve për Agjencinë dhe shtetet anëtare. Deri më sot, EDA ka vendosur aranzhime administrative me 5 vende që nuk janë anëtare të BE-së, ku përfshihen: Norvegjia (nënshkruar më 7 mars 2006) ishte partneri i parë vend i tretë; Zvicra (fillimisht nënshkruar më 16 mars 2012, përditësuar më 1 dhjetor 2025); Serbia (nënshkruar më 13 dhjetor 2013); Ukraina (nënshkruar më 7 dhjetor 2015), duke pasqyruar partneritetin e saj strategjik me BE-në; dhe Departamenti i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara (nënshkruar më 26 prill 2023), duke vlerësuar dimensionin transatlantik të mbrojtjes evropiane.



FIGURE 1: Aranzhimet administrative të EDA-s të nënshkruara me vendet e treta (vitet e nënshkrimit/vendi)

Siç mund të shihet, nga BP6 aktualisht vetëm Serbia ka aranzhime të avancuara administrative strukturore me EDA-n. As Shqipëria e Veriut, as Maqedonia dhe as Mali i Zi si anëtare të NATO-s nuk kanë aranzhime të tilla. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut lidhën së fundmi Partneritetin për Sigurinë

dhe Mbrojtjen (SDP) me BE-në, i cili konsiderohet si hapi i parë fillestar drejt një aranzhimi të tillë. Ndërkohë, Mali i Zi, i cili shihet përgjithësisht si pararendës në procesin e anëtarësimit në BE, është nuk e ka nënshkruar një partneritet të tillë.

19 Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Ministrat e Mbrojtjes të BE-së aprovojnë mandatin e përfunduar për EDA-n, 28 maj 2024, <https://eda.europa.eu/news-and-events/news/2024/05/28/eu-defence-ministers-approve-reinforced-mandate-for-eda>.

20 Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Shqyrtimi Afatgjatë 2024 i Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes: EDA si bërthama ndërqeveritare e mbrojtjes në nivel të BE-së, 2024, <https://eda.europa.eu/docs/default-source/documents/2024-long-term-review-of-the-european-defence-agency.pdf>

21 Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Qendra për Inovacionin e Mbrojtjes së BE-së (HEDI), EDA – Hulumtimet dhe Teknologjia, Bashkimi Evropian, shkurt 2026, <https://eda.europa.eu/what-we-do/research-technology/hedi>

2.3. Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar (PESCO)

Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar (PESCO) është një kornizë ligjërishme e detyrueshme për integrimin e mbrojtjes midis shteteve anëtare të BE-së të interesuara, e lansuar në dhjetor 2017 pasi vendosjes nga Traktati i Lisbonës i vitit 2009.²² Aktivizimi i PESCO-s u nxit nga disa ngjarje gjeopolitike, duke përfshirë Luftën Civile në Siri, krizën evropiane të imigracionit, aneksimin e Krimesë nga Rusia, Brexit-in dhe presionin e SHBA-së ndaj NATO-s. Aktualisht, marrin pjesë 26 shtete anëtare, me Maltën që ka zgjedhur të tërhiqet dhe Danimarkën që iu bashkua në maj 2023.

Anëtarët zotohen për 20 detyrime në pesë fusha: rritja e buxheteve të mbrojtjes, alokimi i fondeve për pajisje dhe hulumtime, harmonizimi i nevojave operacionale, përmirësimi i ndërveprueshmërisë së forcave dhe adresimi i hendekëve të kapaciteteve. Këto zotime monitorohen çdo vit, me pezullim të mundshëm për papajtueshmëri.²³

PESCO koordinon 75 projekte që përfshijnë trajnimin, forcat tokësore, detare, ajrore, mbrojtjen kibernetike dhe mundësuesit strategjikë. Projektet udhëhiqen nga shtetet pjesëmarrëse, të cilat përcaktojnë objektiva dhe afate kohore.²⁴ Shembuj të vlefshëm përfshijnë Lëvizshmërinë Ushtarake, Komandën Mjekësore Evropiane, ekipet e reagimit të shpejtë kibernetik dhe mbikëqyrjen detare. Projekteve u jepet prioritet për mbështetje nga Fondit Evropian për Mbrojtjen.²⁵

Pjesëmarrja e vendeve të treta lejohet sipas kriterëve strikte si vlera e shtuar dhe përafrimi politik. Projekti për Lëvizshmërinë Ushtarake përfshin SHBA-në, Kanadanë, Norvegjinë dhe Mbretërinë e Bashkuar.²⁶ Deri në fillim të vitit 2026, asnjë nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor nuk i është bashkuar asnjë projekti të PESCO-s.

2.4. Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDC)

Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDC), i themeluar në korrik 2005, është organ autonom i BE-së që ofron trajnime dhe edukim për Politikën e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP) dhe Politikën më të gjerë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.²⁷ Duke operuar si një rrjet anëtarësh dhe partnerësh të asociuar, ESDC-ja aktualisht mbledh rreth 277 institute kombëtare trajnime, duke përfshirë akademitë e mbrojtjes, kolegjet e policisë, institutet diplomatike dhe organet e BE-së.²⁸ Misioni i saj është të zhvillojë një kulturë të përbashkët evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes midis personelit

civil dhe ushtarak.²⁹

Kolegji drejtohet nga tri organe kryesore: Komiteti Drejtues (takime tremujore për vlerësimin e nevojave për trajnim dhe aprovimin e kurrikulave), Bordi Ekzekutiv Akademik (sigurimi i cilësisë dhe koherencës akademike) dhe Sekretariati (i udhëhequr nga Drejtuesi i ESDC-së, kryesisht Ekspertë Kombëtarë të Dërguar).³⁰

Trajnimi varion nga kurset fillestare deri te programet strategjike të lidhshme si kursi vjetor i nivelit të lartë për CSDP-në.³¹ Ofertat e specializuara

22 Këshilli i Bashkimit Evropian, Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar (PESCO), qasur më 13 mars 2026, <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/pesco/>

23 Këshilli i Bashkimit Evropian, Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar (PESCO), qasur më 13 mars 2026, <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/pesco/>

24 Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar (PESCO), PESCO – Nën drejtimin e Shteteve Anëtare, qasur më 13 mars 2026, <https://www.pesco.europa.eu/>.

25 Agjencia Evropiane e Mbrojtjes, Bashkëpunimi i Përhershëm i Strukturuar (PESCO), qasur më 13 mars 2026, <https://eda.europa.eu/what-we-do/EU-defence-initiatives/permanent-structured-cooperation-%28PESCO%29>

26 Pyetje dhe Përgjigje: Pjesëmarrja e shteteve të treta në projektet e PESCO-s, 23 maj 2023, https://www.eeas.europa.eu/eeas/questions-answers-third-states%E2%80%99-participation-pesco-projects_en

27 Bashkimi Evropian, Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes, Përmbledhje e Vendimit (CFSP) 2020/1515, EURLex, qasur më 13 mars 2026, https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/1_european-security-and-defence-college.html.

28 Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes, Rrjeti – Si të bëhesh Partner i Asociuar i Rrjetit, qasur më 13 shkurt 2026, https://www.esdc.europa.eu/about-us-0/network_en#becoming-a-associate-network-partner

29 Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes, Misioni, qasur në shkurt 2026, https://www.esdc.europa.eu/about-us-0/mission_en.

30 Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes, Struktura, qasur më 13 mars 2026, https://www.esdc.europa.eu/about-us-0/structure_en.

31 Instituti i Lartë Mbretëror për Mbrojtjen (RHID), "Kursi i Nivelit të Lartë (HLC)" (Pasqyra e kursit të nivelit të lartë për CSDP-në), qasur në mars 2026, <https://>

përfshijnë kurse për këshilltarë politikë në misionet e BE-së, sigurinë kibernetike, aktivitetet elektromagnetike dhe kursin për Zyrtar Kryesor për Siguri të Informacionit (CISO).

Programi Ushtarak Erasmus (Iniciativa Evropiane për Shkëmbimin e Oficerëve të Rinj) shkëmben më shumë se 4,000 kadetë në vit për të nxitur kulturën e përbashkët të sigurisë dhe ndërveprueshmërinë.³² Çdo vit, disa mijëra efektivë marrin pjesë në trajnime të ESDC-së përmes moduleve me prani fizike dhe mësimnxënies elektronike. ESDC-ja prodhon edhe materiale trajnimi, module të mësimnxënies në distancë dhe kontribuon në Doracakun e CSDP-së të përdorur në institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare.

Bashkëpunimi i Ballkanit Perëndimor me ESDC-në përqendrohet në trajnime të përshtatura për CSDP-në, mësimnxënie elektronike dhe seminare. Serbia dhe Shqipëria janë vendet më të integruara: Qendra e Serbisë për Operacione Paqeruajtëse është anëtare zyrtare e asociuar dhe Shqipëria merr pjesë në Erasmus-in Ushtarak dhe e ka integruar bashkëpunimin me ESDC-në në Partneritetin e saj për Sigurinë dhe Mbrojtjen 2024. Maqedonia e Veriut organizon rregullisht kurse për CSDP-në. Kosova, nga ana e saj, ende nuk i është bashkuar formalisht aktiviteteve të ESDC-së deri më tani, duke u kufizuar vetëm në trajnimin e personelit të EULEX-it. Teksa afrohet afati i konsolidimit të FSK-së, Kosova duhet të kërkojë urgjentisht përfshirjen në aktivitetet e ESDC-së.

2.5. Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF)

Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF) shënon një ndryshim të madh në Politikën e BE-së për Mbrojtjen duke siguruar fonde të drejtpërdrejta nga buxheti i BE-së për hulumtime të përbashkëta dhe zhvillim të kapaciteteve. I propozuar në vitin 2016 dhe plotësisht funksional që nga viti 2021, EDF-ja ka buxhet prej 7.953 miliardë eurosh për periudhën 2021-2027, me 2.7 miliardë euro për hulumtime bashkëpunuese dhe 5.3 miliardë euro për projekte për kapacitete.³³

EDF-ja u krijua për të adresuar investimet e pamjaftueshme në hulumtime dhe zhvillim të mbrojtjes, fragmentimin e tregut – 80% e prokurimit ishte kombëtar – dhe duplikimet e kushtueshme, duke kapur nga 25 deri në 100 miliardë euro në vit.³⁴ Programet e mëparshme pilot ishin PADR

(90 milionë euro për tre vjet) dhe EDIDP (500 milionë euro për dy vjet), të dy me synim forcimin e bashkëpunimit, konkurrueshmërisë dhe inovacionit të mbrojtjes së BE-së.³⁵

EDF-ja ofron grante që mbulojnë deri në 100% të kostove të hulumtimit dhe bashkëfinancim për zhvillim, duke priorizuar NVM-të, bashkëpunimin ndërkuftar dhe projektet e lidhura me PESCO-n.³⁶ Projektet kërkojnë të paktën tri entitete nga dy shtete anëtare (tre për veprime për kapacitete). Vendet e asociuara si Norvegjia e kanë mundësinë të anëtarësohen,³⁷ ndërsa vendet e Ballkanit Perëndimor mund të marrin pjesë nën kushte të rrepta, por pa fonde të BE-së, dhe nuk kanë marrë pjesë deri në vitin 2026.

www.defence-institute.be/en/high-studies/hlc/

32 Bashkimi Evropian, "Kolegji Evropian i Sigurisë dhe Mbrojtjes" (pasqyra), qasur në mars 2026, https://european-union.europa.eu/institutions-law-budget/institutions-and-bodies/search-all-eu-institutions-and-bodies/european-security-and-defence-college_en

33 Komisioni Evropian, "Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF) – ueb faqja zyrtare", Industria dhe Hapësira e Mbrojtjes, qasur në mars 2026, https://defence-industry-space.ec.europa.eu/eu-defence-industry/european-defence-fund-edf-official-webpage-european-commission_en

34 Komisioni Evropian, Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF) – Pasqyra e fakteve (PDF), 29 prill 2021, <https://defence-industry-space.ec.europa.eu/system/files/2021-04/20210429%20-%20EDF%20Factsheet.pdf>

35 Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF), EDA – iniciativat e BE-së në fushën e mbrojtjes, qasur në mars 2026, <https://eda.europa.eu/what-we-do/EU-defence-initiatives/european-defence-fund-%28edf%29>

36 Komisioni Evropian, "Fondi Evropian për Mbrojtjen (EDF) – ueb faqja zyrtare", Industria dhe Hapësira e Mbrojtjes, qasur në mars 2026, https://defence-industry-space.ec.europa.eu/eu-defence-industry/european-defence-fund-edf-official-webpage-european-commission_en

37 Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA), Aranzhimi administrativ ndërmjet Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë, 7 mars 2006, <https://ebrokerage.eda.europa.eu/docs/default-source/documents/aa---eda---mod-norway-07-03-06.pdf>

2.6. Instrumenti Evropian për Paqen (EPF)

I themeluar në mars 2021, Instrumenti Evropian për Paqen (EPF) është instrument jashtë buxhetit i BE-së, i financuar drejtpërdrejt nga Shtetet Anëtare, i krijuar për të financuar aktivitetet globale të sigurisë të BE-së që nuk mund të mbështeten nga buxheti i rregullt i BE-së për shkak të kufizimeve të traktatit. Fillimisht i kufizuar në rreth 5 miliardë euro për periudhën 2021-2027, tavanit i EPF-së tani tejkalon 17 miliardë euro, duke reflektuar mbështetjen e zgjeruar ushtarake të BE-së për Ukrainën. Ai bashkon mekanizmat e mëparshëm në një fond të vetëm me dy mandate themelore: njëri mbulon kostot e përbashkëta të misioneve ushtarake të BE-së (si EUFOR Althea në Bosnjë dhe Hercegovinë), ndërsa misionet civile si EULEX-i mbeten të

financuara përmes buxhetit të rregullt të BE-së për të mbajtur një ndarje të rreptë midis operacioneve ushtarake dhe atyre civile.

Mandati i dytë, shtylla e masave të asistencës, i mundëson BE-së të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë për qeveritë partnere për ngritjen e forcave të tyre të armatosura, duke përfshirë trajnime të specializuara, logjistikën dhe pajisjet ushtarake jo-vdekjeprurëse dhe vdekjeprurëse. Kjo e bën EPF-në kanal kryesor për bashkëpunimin e BE-së në mbrojtje me shtetet jo anëtare të BE-së, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, ku fondet e tjera të mbrojtjes së BE-së mbeten kryesisht të paqasshme.

2.7. Komiteti Ushtarak i BE-së (EUMC)

EUMC-ja është organi më i lartë ushtarak në BE, që këshillon Komitetin Politik dhe të Sigurisë dhe drejton Shtabin Ushtarak të BE-së. I përbërë nga Shefat e Mbrojtjes nga të gjitha shtetet anëtare (ose përfaqësuesit e tyre), ai mblidhet dy herë në vit në nivel të Shefave të Mbrojtjes (CHOD) dhe çdo javë në nivel përfaqësues. EUMC-ja ofron ekspertizë ushtarake, vlerëson situatat dhe mbikëqyr operacionet, duke përfshirë mbikëqyrjen

e drejtpërdrejtë të EUFOR Althea në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në takimet e tij ftohen rregullisht partnerët jo-anëtarë të BE-së që kontribuojnë me trupa në misionet e krizave, duke promovuar bashkëpunimin rajonal dhe integrimin në strukturat ushtarake të BE-së si Grupet Luftarake. EUMC-ja është autoriteti kryesor për fuqinë ushtarake të BE-së dhe reagimin ndaj krizave në rajon.

2.8. Baza Teknologjike dhe Industriale e Mbrojtjes Evropiane (EDTIB)

Baza Teknologjike dhe Industriale e Mbrojtjes Evropiane (EDTIB) përbëhet nga industritë e mbrojtjes të BE-së, institucionet për hulumtime dhe ofruesit e teknologjisë që mbështesin pajisjet dhe shërbimet ushtarake. Pasi që pushtimi rus i Ukrainës zbuloi varësinë e Evropës nga furnizuesit e jashtëm, forcimi i EDTIB-së u bë prioritet. Strategjia Industriale e Mbrojtjes Evropiane 2024 (EDIS) përshkruan synimet për zhvillimin e EDTIB-së deri në vitin 2035, duke u fokusuar në investimet bashkëpunuese, reagimin ndaj krizave, zinxhirët e

sigurt të furnizimit dhe partneritetet strategjike.³⁸

Vendet jo-anëtare të BE-së si ato në Ballkanin Perëndimor (BP) kryesisht ndërveprojnë me EDTIB-në si blerës (p.sh., helikopterët francezë, automjetet e blinduara gjermane). Që vendet e BP të marrin pjesë, firmat lokale të mbrojtjes duhet të integrohen në zinxhirët e furnizimit të BE-së, por shumica aktualisht nuk kanë certifikimin e nevojshëm teknologjik dhe lejen e sigurisë, pasi që ato fokusohen në produkte të vjetra ose prodhim bazik.

38 Komisioni Evropian, "EDIS – Strategjia jonë e përbashkët industriale e mbrojtjes", Industria dhe Hapësira e Mbrojtjes, qasur në mars 2026, https://defence-industry-space.ec.europa.eu/eu-defence-industry/edis-our-common-defence-industrial-strategy_en

2.9. Programi për Industrinë e Mbrojtjes Evropiane (EDIP)

Programi për Industrinë e Mbrojtjes Evropiane (EDIP), i miratuar në dhjetor 2025 me 1.5 miliardë euro për periudhën 2025-2027, financon veprimet e përbashkëta të prokurimit, përforcimin industrial për të rritur kapacitetin prodhues dhe Projektet e Mbrojtjes Evropiane me Interes të Përbashkët.³⁹ EDIP përfaqëson kornizën e parë ligjore strukturore

dhe afatgjatë të BE-së të krijuar për shkallëzimin dhe integrimin e përhershëm të Bazës Teknologjike dhe Industriale të Mbrojtjes Evropiane (EDTIB). Zyrtarisht, EDIP gjithashtu i kategorizon vendet e BP si 'vende të treta jo të asociuara' që do të thotë se ato janë tërësisht të përjashtuara nga marrja e fondeve.

³⁹ Këshilli i Bashkimit Evropian, "Programi për Industrinë e Mbrojtjes Evropiane: Këshilli jep aprovimin përfundimtar" (njoftim për shtyp, PDF), 8 dhjetor 2025, <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2025/12/08/european-defence-industry-programme-council-gives-final-approval/pdf/>

III. Dinamikat e brendshme në Ballkanin Perëndimor dhe bashkëpunimi me mekanizmat e mbrojtjes të BE-së

Rajoni i BP 6, i përbërë nga Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, zë një pozicion kritik në arkitekturën e sigurisë së Evropës. Siç u shpjegua më lart, pushtimi rus i Ukrainës në vitin 2022 e ka riformësuar rrënjësisht llogaritjen strategjike për mbrojtjen evropiane, duke e shtyrë Bashkimin Evropian të përshpejtojë angazhimin me vendet candidate në rajon.⁴⁰ Në mbarë BP6 funksionojnë rreth 200 kompani të sektorit të mbrojtjes dhe shpenzimet ushtarake janë rritur për 40 deri në 120 për qind mes viteve 2020 dhe 2025.⁴¹ Megjithatë, rrugët e tyre drejt bashkëpunimit më të thellë me BE-në në fushën e mbrojtjes ndryshojnë ndjeshëm bazuar në statusin e anëtarësimit në NATO, stabilitetin e brendshëm politik dhe përafrimin me politikën e jashtme të BE-së.

Edhe pse BP6 është rajon i vogël nga madhësia, secili prej vendeve të tij paraqet modele mjaft të dallueshme për bashkëpunimin me BE-në në fushën e mbrojtjes. Shqipëria dhe Mali i Zi, si anëtare të NATO-s me rrugë të qarta anëtarësimi në BE, kanë demonstruar trajektore të suksesshme integrimi përkundër risqeve të brendshme politike të Malit të Zi. Maqedonia e Veriut është shembull se si kontestet dypalëshe me anëtarët e BE-së mund të paralizojnë përparimin përkundër anëtarësimit

në NATO ose kapaciteteve të forcave të mbrojtjes. Bosnjë dhe Hercegovina vazhdon të mbetet peng nga fragmentimi i saj i brendshëm. Serbia bën dallim për shkak të këmbënguljes së saj për të mbajtur lidhje të ngushta me Rusinë dhe Kinën,⁴² prirjeve për autoritarizëm qeveritar,⁴³ si dhe rolit të saj si pengues kryesor rajonal, kryesisht në Kosovë⁴⁴ dhe Bosnjë dhe Hercegovinë⁴⁵. Kosova nga ana tjetër, për shkak të mosnjohjes nga shtete anëtare të BE-së përballet me sfida të dukshme në rrugën e saj drejt BE-së, edhe pse është 100% e përafruar me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së dhe mbetet e vendosur pro-BE-së.

Nga ana tjetër, trendet e shpenzimeve të mbrojtjes zbulojnë se edhe rajoni i BP i është bashkuar trendit global të riarmatimit dhe kjo po ndodh në mënyra të ndryshme dhe në një farë mase shqetësuese. Buxheti prej 2.2 miliardë eurosh i Serbisë i bën të duken të vogla buxhetet prej 526 milionë eurosh të Shqipërisë, 150 milionë eurosh të Malit të Zi dhe 208 milionë eurosh të Kosovës.⁴⁶ Në Maqedoninë e Veriut disa raporte sugjerojnë se buxheti i mbrojtjes në vitin 2025 është rreth 180 milionë euro,⁴⁷ ndërsa në Bosnjë dhe Hercegovinë mungojnë të dhënat zyrtare, megjithatë, ka disa sugjerime se ai shkon rreth 260 milionë euro. Megjithëse shpenzimet më të larta mund t'u ndihmojnë vendeve të BP-së të

40 Siguria dhe Mbrojtja Evropiane (ESD), Siguria e BE-së në Ballkanin Perëndimor, Revista Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes, korrik 2025, <https://euro-sd.com/2025/07/articles/exclusive/45585/eu-security-in-the-western-balkans/>

41 Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë (ECFR), Si mundet Ballkani Perëndimor të kontribuojë në mbrojtjen evropiane, ECFR / Carnegie Europe, tetor 2025, <https://carnegieendowment.org/europe/strategic-europe/2025/10/how-the-western-balkans-can-contribute-to-european-defence>

42 Komisioni Evropian, Dokument punues i personelit të Komisionit: Raporti për Serbinë 2024, 30 tetor 2024, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/3c8c2d7f-bff7-44eb-b868-414730cc5902_en?filename=Serbia%20Report%202024.pdf.

43 Freedom House, "Serbia", Kombet në tranzit 2024, 2024, <https://freedomhouse.org/country/serbia/nations-transit/2024>.

44 Parlamenti Evropian, Rezoluta e Parlamentit Evropian e 19 tetorit 2023 për zhvillimet e fundit në dialogun Serbi-Kosovë, përfshirë situatën në komunat e veriut të Kosovës (2023/2880(RSP)), 29 prill 2024, <https://eur-lex.europa.eu/eli/C/2024/2654/oj/eng>.


45 Parlamenti Evropian, Raporti për raportet e Komisionit për Bosnjë dhe Hercegovinën për vitet 2023 dhe 2024 (2025/2018(INI)), A10-0108/2025, 11 qershor 2025, https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/A-10-2025-0108_EN.html.

46 Raporti i Evropës Qendrore, Ballkani Perëndimor rrit ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes, Raporti i Evropës Qendrore, 2024, <https://www.cereport.eu/news/politics/83394>

47 ALTAX, Buxhetet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2025, 22 dhjetor 2024, <https://altax.al/en/western-balkans-budgets-for-2025/>

bashkëpunojnë me BE-në, retorika aktuale sugjeron e paqes dhe sigurisë rajonale. se riarmatimi ka si cak njëri-tjetrin dhe jo ndërtimin

Shpenzimet e raportuara për mbrojtjen gjatë vitit 2025 - Shtetet e BP-së, në Milionë



Më poshtë do të analizohen shkurtimisht perspektivat e secilit vend të BP6 për bashkëpunim me BE-në në fushën e mbrojtjes, duke vlerësuar

kapacitetet e forcave të mbrojtjes, përafrimin politik, faktorët e stabilitetit të brendshëm dhe pengesat e paraqitura nga shtetet anëtare të BE-së.

3.1. Shqipëria

Edhe pse Shqipëria është prapa Serbisë kur bëhet fjalë për krijimin e Bashkëpunimit formal të Mbrojtjes me Bashkimin Evropian, ajo shërben si një shembull i rëndësishëm pozitiv i progresit brenda vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6). Shqipëria dallohet si shtet me orientim të qartë pro-perëndimor, pa sfida të rëndësishme të brendshme politike dhe konteste të mëdha dypalëshe me shtetet fqinje që mund të rrezikojnë procesin e integritimit në BE. Teksa është anëtare e NATO-s që nga viti 2009, së bashku me Malin e Zi, Shqipëria gjatë tri viteve të fundit është edhe kthyer në pararendëse të procesit të anëtarësimit në BE. Ky trend progresiv reflektohet edhe në sektorin e mbrojtjes. Në korrik 2024 Shqipëria pranoi 13 milionë euro nga BE-ja për Forcat e saj të Armatosura përmes Instrumentit Evropian për

Paqen, pasuar nga një paketë shtesë prej 15 milionë eurosh në korrik 2025, duke e çuar në 28 milionë euro mbështetjen totale të BE-së në fushën e mbrojtjes.⁴⁸ Në nëntor 2024, Shqipëria nënshkroi një Partneritet për Siguri dhe Mbrojtje (SDP) me BE-në, çka pritet të sjellë një momentum të ri kur bëhet fjalë për bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë në fushën e mbrojtjes. Ky partneritet konsiderohet një hap i rëndësishëm që krijon një kornizë për dialog të zgjeruar për menaxhimin e krizave, mbështetjen për Ukrainën, përpjekjet për të luftuar kërcënimet hibride dhe sigurinë kibernetike.⁴⁹ Ai gjithashtu demonstron nivel të avancuar të përafrimit me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së.

Shqipëria i ka rritur ndjeshëm investimet e saj në

48 BalkanView, BE-ja aprovon 15 milionë euro shtesë për të rritur kapacitetet e mbrojtjes të Shqipërisë, BalkanView, 2024, <https://balkanview.com/eu-approves-additional-e15-million-to-boost-albanias-defence-capabilities/>

49 Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS), Partneriteti për Sigurinë dhe Mbrojtjen mes Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, EEAS, 2024, https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2024/EU-AL%20Security%20and%20Defence%20Partnership_online.pdf

mbrojtje gjatë pesë viteve të fundit, me buxhetin e saj për vitin 2025 që arriti në 526 milionë euro – pothuajse dyfishi i shumës së alokuar në 2021.⁵⁰ Vendi dislokoi edhe 500 efektivë ushtarakë në misionet e NATO-s dhe BE-së në çdo kohë, duke kontribuar në mënyrë aktive në grupet luftarake në Letoni dhe Bullgari,⁵¹ duke demonstruar gatishmërinë për të dhënë kontribut edhe kur bëhet fjalë për mbrojtjen evropiane.

Në 20 prill 2025, bashkëpunimi i Shqipërisë me BE-në në fushën e mbrojtjes mori një momentum të mëtejshëm me Dialogun e Parë BE-Shqipëri

për Sigurinë dhe Mbrojtjen të mbajtur në Tiranë, ku Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu theksoi përkushtimin e Shqipërisë për të marrë pjesë në misionet e menaxhimit të krizave të udhëhequra nga BE-ja dhe për të pasur qasje në instrumente si instrumenti SAFE për modernizimin e forcave të armatosura.⁵² Përkundër kapaciteteve modeste të industrisë vendase të mbrojtjes, Shqipëria po tërheq investime të huaja dhe po zhvillon kapacitete logjistike me përdorim të dyfishtë për të mbështetur misionet e NATO-s.⁵³

3.2. Mali i Zi

Mali i Zi, anëtar i NATO-s që nga viti 2017, gjatë dekadës së fundit ka qenë vazhdimisht pararendës kur bëhet fjalë për negociatat e anëtarësimit në BE, duke synuar anëtarësimin në vitin 2028.⁵⁴ Vendi i ka hapur të 33 kapitujt negociues dhe ka mbyllur përkohësisht 12 që nga dhjetori 2025, duke e bërë atë të vetmin kandidat që përmbush standardet e përkohshme për kapitujt 23 dhe 24 për sundimin e ligjit.⁵⁵

Megjithatë, ndryshe nga Shqipëria, Mali i Zi përballet me disa sfida të dukshme të brendshme. Peizazhi politik gjatë viteve të fundit ka qenë mjaft i përçarë, me partitë nacionaliste pro-serbe që ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm politik dhe Kishën Ortodokse Serbe që luan rol kontestues në politikën e brendshme.⁵⁶

Buxheti i mbrojtjes i Malit të Zi për vitin 2024 arriti në 150 milionë euro dhe vendi ndan 1.8 për qind të BPV-së për shpenzimet ushtarake.⁵⁷ Dialogu i parë BE-Mali i Zi për Sigurinë dhe Mbrojtjen u mbajt në Bruksel në dhjetor 2025, ku Përfaqësuesja e Lartë Kaja Kallas theksoi mbështetjen e BE-së për synimin e anëtarësimit të Malit të Zi në vitin 2028. Mali i Zi është zotuar të përafrohet me iniciativat e BE-së në fushën e mbrojtjes dhe ka përfutur një Masë të Asistencës në kuadër të Instrumentit Evropian për Paqen për të rritur kapacitetet e forcave të armatosura dhe ndërveprueshmërinë.⁵⁸ Vlera strategjike e vendit qëndron në integrimin e tij të plotë në NATO të kombinuar me përparimin e shpejtë drejt anëtarësimit në BE, megjithëse rrymat politike pro-ruse dhe pro-serbe paraqesin risqe të vazhdueshme për orientimin e tij perëndimor.

50 Raporti i Evropës Qendrore, Ballkani Perëndimor rrit ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes, Raporti i Evropës Qendrore, 2024, <https://www.cereport.eu/news/politics/83394>.

51 Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë (ECFR), Si mundet Ballkani Perëndimor të kontribuojë në mbrojtjen evropiane, Raporte të thelluara, 7 nëntor 2025, <https://indepthreports.eu/2025/11/07/how-the-western-balkans-can-contribute-to-european-defence/>

52 Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, Ministri Vengu në Takimin e Parë të Dialogut BE - Shqipëri për Sigurinë dhe Mbrojtjen: Forcojmë aftësitë mbrojtëse, për një rajon më të sigurt, MM Shqipëri, 2024, <https://www.mod.gov.al/en/newsroom/1879-minister-vengu-at-the-first-eu-albania-security-and-defence-dialogue-strengthening-defence-capabilities-for-a-safer-region>

53 Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë (ECFR), Si mundet Ballkani Perëndimor të kontribuojë në mbrojtjen evropiane, Raporte të thelluara, 7 nëntor 2025, <https://indepthreports.eu/2025/11/07/how-the-western-balkans-can-contribute-to-european-defence/>

54 Parlamenti Evropian, Shërbimi Parlamentar Evropian për Hulumtime (EPRS), Raportet e Komisionit për Malin e Zi 2023 dhe 2024, Parlamenti Evropian, 2025, https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2025/772900/EPRS_ATA%282025%29772900_EN.pdf

55 New Union Post, Negociatat e anëtarësimit të Malit të Zi 2025: Mbyllja e kapitujve dhe perspektivat për anëtarësim në BE, New Union Post, 16 dhjetor 2025, <https://newunionpost.eu/2025/12/16/montenegro-accession-negotiations-2025/>; https://en.wikipedia.org/wiki/Accession_of_Montenegro_to_the_European_Union

56 Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë (ECFR), Integrimi i Malit të Zi në Bashkimin Evropian mes ndikimit rus dhe serb, Blue Europe, 2024, <https://www.blue-europe.eu/analysis-en/full-reports/the-integration-of-montenegro-in-the-european-union-amidst-russian-and-serbian-influence/>.

57 Raporti i Evropës Qendrore, Ballkani Perëndimor rrit ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes, Raporti i Evropës Qendrore, 2024, <https://www.cereport.eu/news/politics/83394>

58 Qeveria e Malit të Zi dhe Shërbimi Evropian i Veprimtë Jashtëm (EEAS), Mbahet takimi i parë i Dialogut BE-Mali i Zi për Sigurinë dhe Mbrojtjen: Forcimi i bashkëpunimit dhe partneritetit strategjik, Qeveria e Malit të Zi, 2024, <https://www.gov.me/en/article/first-eu-montenegro-security-and-defence-dialogue-held-strengthening-cooperation-and-strategic-partnership>.

3.3. Maqedonia e Veriut

Nga pikëpamja e mbrojtjes, Maqedonia e Veriut ka ruajtur një nivel relativisht të fortë të përpjekjeve: buxheti i saj i mbrojtjes për vitin 2024 u raportua në 329 milionë euro, duke përfshirë 106 milionë euro të destinuar për pajisje dhe modernizim, që korrespondon me rreth 2.1 për qind të BPV-së.⁵⁹ Vendi gjithashtu mban poligonin stërvitor në Krivolak, i cili është kthyer në lokacion të rëndësishëm për trajnimet dhe stërvitjet e aleatëve, si dhe ka lidhur një Partneritet për Sigurinë dhe Mbrojtjen me BE-në, duke e vendosur atë, të paktën formalisht, ndër partnerët më të avancuar të rajonit në fushën e mbrojtjes së BE-së.⁶⁰

Megjithatë, Maqedonia e Veriut vazhdon të ilustrojë se si kontestet dypalëshe mund të pengojnë

integrimin në BE dhe, si rrjedhojë, të komplikojnë bashkëpunimin më të thellë në fushën e mbrojtjes me Unionin – edhe pas anëtarësimit në NATO (2020). Pas zgjidhjes së kontestit të gjatë për emrin me Greqinë përmes Marrëveshjes së Prespës të vitit 2018, Shkupi hasi në një bllokim të ri nga Bullgaria të lidhur me çështje historike dhe gjuhësore.⁶¹ Sofja gjithashtu e ka kushtëzuar përparimin me ndryshime kushtetuese, duke përfshirë njohjen formale të pakicës bullgare, një çështje që qeveria e Maqedonisë së Veriut e ka trajtuar me kujdes.⁶² Kështu, edhe pse Maqedonia e Veriut është kandidatë për në BE që nga viti 2005 dhe hapi zyrtarisht negociatat e anëtarësimit në vitin 2022, procesi mbetet efektivisht i ngrirë për shkak të vetos bullgare.

3.4. Serbia

Serbia zë një pozicion unik dhe kontradiktor në dinamikën e mbrojtjes së BP6. Përkundër ruajtjes së lidhjeve të ngushta me Rusinë dhe refuzimit që të vendoste sanksione pas pushtimit të Ukrainës, Serbia nënshkroi një aranzhim administrative me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes në vitin 2013. Serbia ndau 2.2 miliardë euro për mbrojtjen në vitin 2024, vlere më e lartë në Ballkanin Perëndimor dhe gati pesëfishi i buxhetit të Shqipërisë.⁶³ Për dekada me radhë Serbia ka bërë lojë të dyfishtë, duke blerë armatim si nga Lindja ashtu edhe nga Perëndimi, duke blerë avionë luftarakë Rafale nga Franca dhe duke mbajtur sisteme kineze të dronëve dhe mbrojtjes raketore.⁶⁴

Serbia është prodhuesi më i madh i armëve në BP6, megjithatë eksportet e saj janë bërë kontraverse.

Inteligenca ruse akuzoi Beogradin në maj 2024 për dërgimin e municioneve në Ukrainë përmes ndërmjetësve, pretendime që Serbia i mohoi zyrtarisht, ndërkohë që pretendon vlerësime në formë të nënkuptuar.⁶⁵ Në qershor 2025, presidenti Aleksandar Vuçiq shpalli ndalesë të plotë të eksporteve të armëve, duke përmendur presionin ndërkombëtar dhe shfaqjen e municioneve serbe në të dyja anët e konfliktit në Ukrainë.⁶⁶

Rreshtimi i forcave të mbrojtjes të Serbisë ndërlikohet më tej nga ambicia e saj ndaj shtetit të Kosovës. Sulmi terrorist i shtatorit 2023 në Banjskë, ku një grup terrorist i armatosur vrau një zyrtar policor të Kosovës, implikoi përfshirjen e shtetit serb dhe demonstroi kapacitetin destabilizues të Beogradit.⁶⁷ Rusia i mbështet përpjekjet e

59 Raporti i Evropës Qendrore, Ballkani Perëndimor rrit ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes, Raporti i Evropës Qendrore, 2024, <https://www.cereport.eu/news/politics/83394>

60 ARMATA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, "Vazhdojnë operacionet në kuadër të stërvitjes ndërkombëtare IR 25" (aktivitetet stërvitore në ATA 'Krivollak' me NATO-n dhe njësitë partnere), 30 maj 2025, <https://mil.mk/exercises/techat-aktivnosti-vo-ramki-na-megjunarodnata-vezhba-ir-25/?lang=en>

61 Euronews, Marina Stoimenova, Konfliktet me fqinjët bëhen pengesë për Maqedoninë e Veriut në dyert e BE-së, Euronews, 31 tetor 2025, <https://www.euronews.com/2025/10/31/neighbourly-conflicts-hinder-north-macedonia-at-the-gates-of-the-eu>

62 Po aty

63 Raporti i Evropës Qendrore, Ballkani Perëndimor rrit ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes, Raporti i Evropës Qendrore, 2024, <https://www.cereport.eu/news/politics/83394>

64 Radio Evropa e Lirë (REL), Jelena Jankovic dhe Ljudmila Cvetkovic, Serbia thellon lidhjet ushtarake me Kinën përmes dronëve dhe sistemeve të mbrojtjes ajrore, Radio Evropa e Lirë/Radio Liria, 7 janar 2026, <https://www.rferl.org/a/serbia-china-military-cooperation-drones-air-defence-security/33626646.html>

65 Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë (ECFR), Si mundet Ballkani Perëndimor të kontribuojë në mbrojtjen evropiane, ECFR / Carnegie Europe, tetor 2025, <https://carnegieendowment.org/europe/strategic-europe/2025/10/how-the-western-balkans-can-contribute-to-european-defence>

66 Radio Evropa e Lirë (REL), Mila Manojlovic, Vuçiqi ndalon eksportet e municioneve, thotë se furnizimet do të shkojnë për ushtrinë serbe, Radio Evropa e Lirë, 26 qershor 2025, <https://www.rferl.org/a/serbia-arms-exports-ukraine-russia-vucic/33453578.html>

67 Prishtina Insight, Ardita Zeqiri dhe Adelina Ahmeti, Raporti i Kosovës zbulon detajet e sulmit terrorist në Banjskë, Prishtina Insight, 27 tetor 2023, <https://>

mundshme të Vuçiqit për të nxitur inkursion të armatosur në Kosovë, një skenar që do ta sfidonte në themel stabilitetin rajonal. Kështu, edhe pse Serbia mund të jetë e pozicionuar më mirë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e BE-së, marrë parasysh kapacitetin e saj industrial dhe aranzhimin e EDA-s,

në parim ajo përfaqëson një sfidë themelore për shkak të refuzimit të saj për t'u përafuar me politikën e jashtme të BE-së ndaj Rusisë, kontesteve të saj territoriale me Kosovën dhe paqëndrueshmërisë së përgjithshme që sjell në mbarë rajonin e BP-së.

3.5. Bosnjë dhe Hercegovina

Bosnjë dhe Hercegovina paraqet rastin më kompleks mes vendeve të BP6 për shkak të strukturës së saj politike trepalëshe dhe ndarjeve të brendshme. Vendi mbetet në Planin e Veprimit të Anëtarësimit në NATO që nga viti 2010, por përballat me pengesa sistematike nga Republika Srpska, një nga dy entitetet përbërëse të saj.⁶⁸ Presidenti i Republikës Srpska, Milorad Dodik, ka miratuar legjislacionin që ua ndalon institucioneve gjyqësore dhe policore të nivelit shtetëror të vepron në territorin e RS dhe u dënua në shkurt 2025 me një vit burgim për sfidimin e vendimeve të Përfaqësuesit të Lartë, megjithëse ai vazhdon të shërbejë si president.⁶⁹ Buxheti i mbrojtjes i Bosnjës mendohet të jetë më i ulëti në rajon, në masën prej 0.7 për qind të BPV-së.⁷⁰

Pavarësisht mosfunksionimit politik, Bosnja zotëron kapacitete të konsiderueshme të industrisë së mbrojtjes të trashëguara nga Jugosllavia. Vendi ka

rreth 200 kompani të mbrojtjes, duke përfshirë Pretis Vogošća, BNT Novi Travnik dhe Binas Bugojno, me potencial të kombinuar prodhimi që tejkalon disa ndërmarrje të BE-së.⁷¹ Eksportet ushtarake të Bosnjës arritën në 200 milionë euro në vitin 2025, dyfishi i shifrës së vitit 2023, me produkte që përfshijnë municione të standardit të NATO-s dhe të kalibrit sovjetik.⁷²

BE-ja mban Operacionin Althea (EUFOR) në Bosnjë me mbi 1,000 trupa dhe NATO aprovoi një paketë të Mbrojtjes dhe Ngritjes së Kapaciteteve të Sigurisë në shkurt 2023 që mbulon menaxhimin e krizave, mbrojtjen kibernetike dhe luftimin e terrorizmit.⁷³ Megjithatë, kriza e brendshme politike e Bosnjës – e karakterizuar nga retorika secesioniste dhe sfidat kushtetuese të Dodikut – e bën bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes shumë të paqëndrueshëm dhe të varur nga mbikëqyrja ndërkombëtare.

3.6. Kosova

Kosova e shpalli pavarësinë në vitin 2008 me mbështetje të fortë nga Shtetet e Bashkuara dhe mbështetje të gjerë në mbarë Bashkimin Evropian. Megjithatë, përparimi i saj drejt integritimit në BE dhe NATO mbetet i kufizuar nga mosnjohja e

vazhdueshme e shtetësisë së saj nga pesë shtete anëtare të BE-së, Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja, katër prej të cilave janë gjithashtu anëtare të NATO-s⁷⁴, përkundër qëndrimit të qartë pro-perëndimor të Kosovës. Arkitektura e mbrojtjes

prishtinainsight.com/kosovos-report-reveals-banjska-terrorist-attack-details-mag

68 Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Marrëdhëniet me Bosnjë dhe Hercegovinën, Faqja e temës së NATO-s, 09 dhjetor 2025, <https://www.nato.int/en/what-we-do/partnerships-and-cooperation/relations-with-bosnia-and-herzegovina>

69 Raporti i Këshillit të Sigurimit, Bosnjë dhe Hercegovina, Parashikimi Mujor, maj 2025, <https://www.securitycouncilreport.org/monthly-forecast/2025-05/bosnia-and-herzegovina-13.php>.

70 Raporti i Evropës Qendrore, Ballkani Perëndimor rrit ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes, Raporti i Evropës Qendrore, 2024, <https://www.cereport.eu/news/politics/83394>

71 Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë (ECFR), Si mundet Ballkani Perëndimor të kontribuojë në mbrojtjen evropiane, ECFR / Carnegie Europe, tetor 2025, <https://carnegieendowment.org/europe/strategic-europe/2025/10/how-the-western-balkans-can-contribute-to-european-defence>

72 Fair Observer, Riarmatimi në heshtje i Bosnjës: Si po bëhet një industri e vogël e mbrojtjes furnizuesi i fshehur i Evropës, Fair Observer, 2024, <https://www.fairobserver.com/business/bosnias-quiet-rearmament-how-a-small-defence-industry-is-becoming-europes-hidden-supplier/>

73 Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), "Marrëdhëniet me Bosnjë dhe Hercegovinën", NATO (faqja e temës), <https://www.nato.int/en/what-we-do/partnerships-and-cooperation/relations-with-bosnia-and-herzegovina>.

74 Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG), Kosova: Zhbllkimi i perspektivës Euro-Atlantike – BE, Dialogu për Normalizim të Marrëdhënieve me Serbinë dhe mundësitë për njohje nga 5 shtetet mos-njohëse të BE-së, Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan, mars 2023, <https://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2023/03/Kosovo-Unlocking-its-Euro-Atlantic-Path-1.pdf>

së Kosovës përqendrohet në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), e themeluar në vitin 2009 në përputhje me Planin e Ahtisaarit si organ i mbrojtjes civile me armatim të lehtë.⁷⁵ Në dhjetor 2018, Kuvendi i Kosovës votoi për shndërrimin e FSK-së në ushtri të rregullt, Forcat e Armatosura të Kosovës, duke u zgjeruar nga 2,500 në 5,000 personel aktiv me misionet të mbrojtjes territoriale – një shndërrim i parashikuar të përfundojë deri në vitin 2028.⁷⁶ Kryeministri Albin Kurti ka zotuar mbi 1 miliard euro për mbrojtjen gjatë katër viteve, me buxhetin e vitit 2025 që arriti në 208 milionë euro, nga 69 milionë euro në vitin 2021.⁷⁷ Mbështetja publike për anëtarësimin në NATO në Kosovë është 92 për qind në mesin e të gjithë qytetarëve dhe 99.5 për qind në mesin e shqiptarëve të Kosovës.⁷⁸

Megjithatë, marrëdhëniet e drejtpërdrejta politike ndërmjet NATO-s dhe Kosovës janë përballur me kufizime që nga viti 2018, kryesisht për shkak të qëndrimit të ngurtë të mosnjohësve.⁷⁹ Siguria e Kosovës mbetet e garantuar nga misioni i NATO-s KFOR me rreth 5,200 trupa,⁸⁰ i cili po vazhdon të mbështesë zhvillimin e FSK-së dhe Ministrisë së saj, megjithëse formalisht e injoron procesin e shndërrimit që filloi në vitin 2018.⁸¹ Nga ana tjetër, bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian në sektorin e mbrojtjes deri më sot ka mbetur relativisht i kufizuar dhe është realizuar kryesisht përmes mekanizmave të tërthortë dhe iniciativave për ngritjen e kapaciteteve, dhe jo përmes kornizave formale të partneritetit të

qasshme për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Kjo situatë i atribuohet kryesisht aranzhimeve pas pavarësisë të përshkruara në Planin Ahtisaari, i cili edhe pse jo shprehimisht, në mënyrë të nënkuptuar u caktoi role specifike BE-së dhe NATO-s. BE-ja, përmes dislokimit të EULEX-it, mori përgjegjësinë për monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e institucioneve të sundimit të ligjit dhe gjyqësorit, duke ruajtur përkohësisht kompetencat e rezervuara policore dhe gjyqësore. Njëkohësisht, zhvillimi i FSK-së dhe Ministrisë së saj iu besua NATO-s.

Në atë kohë, kjo ndarje e roleve konsiderohej pragmatike dhe e përshtatshme, marrë parasysh kapacitetet ushtarake të pazhvilluara të BE-së. Megjithatë, në katër vitet e fundit, roli i BE-së si akter i mbrojtjes është zgjeruar ndjeshëm, duke nënvizuar rëndësinë në rritje që Kosova të synojë dhe të vendosë bashkëpunim të drejtpërdrejtë me BE-në në këtë fushë. Me njoftimin e lansimit të elementëve të parë të industrisë së mbrojtjes së Kosovës, është bërë me dije se prodhimi i municioneve, raketave dhe dronëve do t'i shërbejë blerjeve nga autoritetet e Kosovës, përfshirë edhe nga aleatët e saj. Kosova e ka renditur si një nga prioritetet e saj eksplorimin e mënyrave të rritjes së bashkëpunimit me BE-në në fushën e mbrojtjes, duke e konsideruar këtë një nga objektivat e saj që i shërben interesit të ndërsjellë, ndërkohë që vihet në pah si segment i specializuar në marrëdhëniet ekzistuese ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

75 Kombet e Bashkuara, Martti Ahtisaari, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani Ahtisaari), dokument i Këshillit të Sigurimit të OKB-së S/2007/168/Add.1, 26 mars 2007, <https://digitallibrary.un.org/record/595359>;

76 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr.06/L123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (i ndryshuar) dhe legjislati shoqëruar për mbrojtjen që themelon Ministrinë e Mbrojtjes dhe rregullon shndërrimin e FSK-së, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14 dhjetor 2018 (siç është plotësuar/ndryshuar deri më 27 dhjetor 2024), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18375&langid=2>

77 Raporti i Evropës Qendrore, Ballkani Perëndimor rrit ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes, Raporti i Evropës Qendrore, 2024, <https://www.cereport.eu/news/politics/83394>

78 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Leureta Lumi, Diskutim i marrëdhënieve KosovëNATO: Perspektivat për bashkëpunim më të madh, QKSS, 26 qershor 2024, <https://qkss.org/al/publikimet/diskutim-i-marredhenieje-kosove-nato-perspektivat-per-bashkepunim-me-te-madh>

79 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS/QKSS), Ramadan Ilazi dhe Jeta Loshaj, Eksplorimi i opsioneve për avancimin e marrëdhënieve KosovëNATO, QKSS, 10 mars 2025, <https://qkss.org/en/publikimet/exploring-options-for-advancing-kosovo-nato-relations/>

80 Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), roli i NATO-s në Kosovë, Faqja e temës së NATO-s, përditësuar më 9 shkurt 2026, <https://www.nato.int/en/what-we-do/operations-and-missions/natos-role-in-kosovo>

81 Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), roli i NATO-s në Kosovë, Faqja e temës së NATO-s, përditësuar më 9 shkurt 2026, <https://www.nato.int/en/what-we-do/operations-and-missions/natos-role-in-kosovo>

Tabela krahasuese e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor

VENDI	STATUSI NATO	STATUSI EU	BASHKËPUNIMI ME EDA-N	PIKAT E FORTA KYÇE	KUFIZIMET KRYESORE
Shqipëria	Anëtare e NATO-s (2009)	Kandidate	Asnjë	Kontribute paqeruajtëse; qendër logjistike	Bazë e kufizuar industriale
Mali i Zi	Anëtar i NATO-s (2017)	Kandidat	Asnjë	Pozicioni strategjik në Adriatik	Resurse shumë të kufizuara
Maqedonia e Veriut	Anëtare e NATO-s (2020)	Kandidate	Asnjë	Poligoni për stërvitjes ushtarake në Krivollak	Kapacitetet në shkallë të vogël
Serbia	Jo anëtare	Kandidate	Aranzhim Administrativ (2013)	Bazë industriale e trashëguar e mbrojtjes	Përafrim me Rusi-Kinë; mosnjohja e Kosovës;
Bosnjë dhe Hercegovina	Jo anëtare	Kandidate e mundshme	Asnjë	Infrastrukturë e mbrojtjes nga epoka e Jugosllavisë	Ndarjet e brendshme; pengesa nga Republikës Srpska
Kosova	Jo anëtare (aspiruese)	Kandidate e mundshme	Asnjë	Potencial për siguri kibernetike/ TIK; mbështetje shumë e lartë publike properëndimore	Mosnjohja nga 5 shtete anëtare të BE-së (përfshirë 4 anëtarë të NATO s)

IV. Zhvillimi i Sektorit të Mbrojtjes në Kosovë dhe bashkëpunimi i saj me BE-në

4.1. Pasqyra e Sektorit të Mbrojtjes në Kosovë

Spektori i mbrojtjes i Kosovës rrodhi nga procesi i shtetndërtimit pas konfliktit pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Ministria e saj u krijuan nga themeli në kuadër të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i njohur si Plani i Ahtisaarit, i cili rekomandonte pavarësinë e mbikëqyrur dhe përcaktonte që FSK-ja do të kishte vetëm mandat të mbrojtjes civile për vitet e para të saj.⁸² Kjo përgjegjësi u vendos nën mbikëqyrjen e NATO-s, duke reflektuar praninë e misionit të KFOR-it në Kosovë që nga viti 1999 dhe fokusin e kufizuar ushtarak të BE-së në atë kohë. Kjo ndarje e punës nënkuptonte që BE-ja do të kursehej kryesisht nga përfshirja e drejtpërdrejtë me institucionet e mbrojtjes së Kosovës, duke çuar në pasiguri se si do të angazhohet me këtë sektor në të ardhmen.

FSK-ja u konsolidua me shpejtësi, duke arritur kapacitete të plota operationale brenda mandatit fillestar të mbrojtjes civile deri në shtator 2013.⁸⁴ Në vijim, institucionet e Kosovës iniciuan Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë të botuar në mars 2014, i cili propozoi shndërrimin e FSK-së në forca të armatosura në shkallë të vogël.⁸⁵ Megjithatë, rrethanat politike e shtynë këtë proces deri në dhjetor 2018, kur Kuvendi i Kosovës miratoi një paketë legjislative gjithëpërfshirëse të përbërë nga tre ligje të ndërlidhura: Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ligji për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.⁸⁶ Kjo kornizë legjislative i dha FSK-së mandatin e forcave të armatosura me kapacitete ushtarake, duke e

shndërruar atë nga një forcë e kufizuar mbrojtëse civile në një institucion përgjegjës për mbrojtjen territoriale, kontributet e sigurisë kolektive dhe reagimin ndaj krizave.

Shndërrimi vendosi një periudhë dhjetëvjeçare nga 2018 deri në 2028, e strukturuar sipas tri fazave progresive të dizajnuara për ngritjen sistematike të kapaciteteve duke i menaxhuar ndjeshmëritë ndërkombëtare. Objektivat fillestare të strukturës së forcës parashikonin 5,000 pjesëtarë të rregullt aktivë dhe 3,000 rezervistë, të pajisur ekskluzivisht me armë mbrojtëse.⁸⁷ Përgjigja e NATO-s ndaj shndërrimit pasqyroj edhe një herë kompleksitetin politik të krijuar nga mosnjohja nga katër anëtarë të NATO-s (Spanja, Sllovakia, Rumania dhe Greqia). Teksa NATO ende nuk e ka pranuar formalisht këtë proces shndërrimi, aleanca e ka ruajtur bashkëpunimin e ngjashëm me FSK-në e re të transformuar, duke lejuar që të vazhdojë bashkëpunimi funksional përkundër kufizimeve politike.

Shndërrimi i FSK-së në forca të armatosura ka rëndësi të madhe për disa arsye. Së pari, adreson hendekun e sigurisë që deri më tani është mbushur vetëm nga KFOR-i, duke i ofruar NATO-s një alternativë të mundshme nëse anëtarët e saj vendosin ta rregullojnë misionin e tyre në të ardhmen. Ky shndërrim ofron një shtresë sigurie shtesë për qytetarët e Kosovës, veçanërisht marrë parasysh se Kosova mbetet formalisht e kërcënuar nga Serbia, e cila refuzon ta njohë shtetësinë e

82 Martti Ahtisaari, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Aneksi VIII: Sektori i Sigurisë së Kosovës, Dok. i OKB-së S/2007/168/Add.1 (Nju Jork: Kombet e Bashkuara, 26 mars 2007), <https://digitallibrary.un.org/record/595359>.

83 Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), "Roli i NATO-s në Kosovë", NATO, përditësimi i fundit më 9 shkurt 2026, <https://www.nato.int/en/what-we-do/operations-and-missions/natos-role-in-kosovo>

84 Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), "Roli i NATO-s në Kosovë", NATO, përditësimi i fundit më 9 shkurt 2026, <https://www.nato.int/en/what-we-do/operations-and-missions/natos-role-in-kosovo>

85 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë të Republikës së Kosovës, mars 2014, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Analysis-of-Strategic-Security-Sector-Review-of-RKS-060314.pdf>.

86 Florian Qehaja dhe Ramadan Ilazi, Shkundja e miteve për tranzicionin e FSK-së në forcë mbrojtëse, Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), qershor 2021, https://qkss.org/images/uploads/files/KSF_Eng_223324.pdf

87 Florian Qehaja dhe Ramadan Ilazi, Shkundja e miteve për tranzicionin e FSK-së në forcë mbrojtëse, Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), qershor 2021, https://qkss.org/images/uploads/files/KSF_Eng_223324.pdf

saj. Më e rëndësishmja është se ky shndërrim i ka mundësuar Kosovës të zgjerojë bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh me vendet aleate në sektorin e mbrojtjes, duke shënuar ndryshim madhor nga thjesht përfituese e mbështetjes ndërkombëtare të mbrojtjes përmes kalimit gradual

në kontribuese për paqen dhe sigurinë diku tjetër. Ndërkohë, zhvillimet gjeopolitik që rezultuan me kërcënime në rritje të sigurisë dhe mbrojtjes kanë shkaktuar një proces të përshpejtuar të konsolidimit të saj i cili do të theksohet më poshtë.

4.2. Përgjigja e Kosovës ndaj sfidave në rritje të sigurisë: mes veprimeve të nevojshme dhe shqetësimeve të BE-së nga përshkallëzimi

Gjatë viteve të fundit, marrëdhëniet politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë përqesuar ndjeshëm dhe është ulur angazhimi konstruktiv në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Ky trend është i lidhur ngushtë me zhvillimet politike në Serbi, ku forcat nacionaliste u rikthyen në pushtet në vitin 2016, duke e komplikuar kështu dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe duke i rritur tensionet dypalëshe, veçanërisht në pjesën e veriut të Kosovës.

Dinamika ndryshoi edhe kur Albin Kurti u kthye në pushtet pas një ndërprerje të shkurtër në vitin 2020. Ndër hapat e parë të qeverisë së re ishte forcimi i zbatimit të sundimit të ligjit në katër komunat veriore, me qëllimin e deklaruar për të çmontuar strukturat paralele dhe për të forcuar pajtueshmërinë ligjore. Këto masa u kundërshtuan si nga 'Lista Serbe' – një parti satelitore e lidhur me Beogradin – ashtu edhe nga strukturat e jashtëligjshme të kontrolluara nga Beogradi. Hapi me më shumë pasoja u hodh në nëntor 2022, kur përfaqësuesit serbë të Kosovës dhanë dorëheqje kolektive nga institucionet e Kosovës në katër komunat veriore me shumicë serbe, duke përfshirë zyrtarët policorë, prokurorët, gjyqtarët dhe kryetarët e komunave – pas një takimi në Serbi të organizuar nga Lista Serbe.

Për të adresuar vakuumin institucional që rezultoi, autoritetet e Kosovës vendosën menjëherë personel nga rajone të tjera, kryesisht nga shumica shqiptare. Ata gjithashtu organizuan zgjedhje të parakohshme lokale në katër komunat veriore, menjëherë pasi u arrit "Marrëveshja e Brukselit për normalizimin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë" e lehtësuar nga BEja

dhe aneksi i zbatimit të saj. Megjithatë, zgjedhjet u bojkotuan përkundër thirrjeve nga komuniteti ndërkombëtar për pjesëmarrje; për pasojë, kandidatët shqiptarë i fituan të katër pozitave të kryetarëve të komunave. Komuniteti ndërkombëtar e pranoi kryesisht ligjshmërinë e hapave të Kosovës, përfshirë rezultatet e zgjedhjeve, por bëri thirrje për përmbajtje për shkak të risqeve të përshkallëzimit.⁸⁸

Përkundër këtyre shqetësimeve, qeveria vazhdoi me instalimin e kryetarëve të rinj në komunat veriore. Ky vendim e shtyu BE-në të vendosë masa të përkohshme, të kthyeshme, duke përfshirë ngrirjen e fondeve të caktuara dhe pezullimin e takimeve të nivelit të lartë të Stabilizim-Asocimit. Megjithatë, toni kritik i BE-së duket se u keqkuptua nga strukturat paralele të lidhura me Beogradin si një ndryshim në momentum, duke nxitur rrjedhimisht përshkallëzim të mëtejshëm. Për pasojë, protestat në këto 4 komuna u intensifikuan dhe u bënë gjithnjë e më të dhunshme.

Më 29 maj 2023, përleshjet e dhunshme shpërthyen në komunën veriore të Zveçanit me shumicë serbe kur protestuesit sulmuan forcat paqeruajtëse të NATO-s (KFOR) dhe Policinë e Kosovës me shkopinj, kokteje molotov, mjete shpërthyes të improvizuara dhe armë zjarri. Sulmet e paprovokuara plagosën 93 ushtarë të KFOR-it, duke përfshirë 11 efektivë italianë dhe 19 hungarezë që pësuan frakturë dhe djegie, me tre ushtarë hungarezë të plagosur nga armët e zjarrit.⁸⁹ Megjithatë, përkundër ashpërsisë së sulmit, në përpjekje për të mos përshkallëzuar situatën, gjuha e komunitetit ndërkombëtar ndaj kësaj dhune të përdorur nga protestuesit ishte kryesisht e moderuar.

⁸⁸ Zyra e Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit e Mbretërisë së Bashkuar (në emër të Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA), "Deklarata e përbashkët për Kosovën", 18 maj 2023, <https://www.gov.uk/government/news/joint-statement-on-kosovo>

⁸⁹ NATO KFOR, "Përditësimi i KFOR-it për sulmet e paprovokuara në Zveçan", Komanda e Forcave të Përbashkëta Aleate Napoli (KFOR News), 30 maj 2023, <https://jfcnaples.nato.int/kfor/media-center/archive/news/2023/kfor-update-on-unprovoked-attacks-in-zvecan>.

Dy javë më vonë, më 14-15 qershor 2023, u raportua se tre policë të Kosovës u rrëmbyen afër kufirit, brenda Kosovës, nga një grup i maskuar dhe me uniformë dhe më pas u dërguan në Serbi, ku u morën në mbajtje nga forcat serbe. Autoritetet e Kosovës e përshkruan incidentin si "rrëmbim" dhe akt "hakmarrje" për arrestimin e mëparshëm të një të dyshuari serb të Kosovës, ndërsa siç pritej autoritetet serbe dhanë versionin e kundërt.⁹⁰ Komuniteti ndërkombëtar u përgjigj sërish me kujdes duke deklaruar vetëm se Policia e Kosovës nuk kishte ndërmend të kalonte kufirin dhe se zyrtarët policorë duhej të liroheshin menjëherë.

Megjithatë, gjuha e kujdesshme e përdorur në të dyja këto incidente të lartpërmendura dhe qëndrimi i ashpër i BE-së ndaj Kosovës nuk dhanë efekte të uljes së tensionit në anën serbe. Përkundrazi, këto qëndrime duket se vetëm i inkurajuan strukturat e jashtëligjshme në veri, pasi që mbetje të ndodhte incidenti më i rëndë. Më 24 shtator 2023, një grup militant serb i armatosur rëndë i udhëhequr nga Milan Radoiçiq, ish-nënkryetar i partisë Lista Serbe, nisi një sulm terrorist në fshatin Banjskë afër kufirit Serbi-Kosovë.⁹¹ Ndërmjet 30 dhe 80 militantë i zunë pritë një autokolone të Policisë së Kosovës, me rreshterin Afrim Bunjaku që u vra dhe dy zyrtarë policorë të tjerë që u plagosën, përpara se të barrikadoheshin në Manastirin e Banjskës. Policia e Kosovës përfundimisht e rimori manastirin pas disa orësh të shtënash me armë, duke vrarë tre

militantë dhe duke sekuestruar mijëra armë dhe pajisje me vlerë më të madhe se 5 milionë euro, përfshirë armë të prodhuara në Serbi që nuk mund të gjenden në treg të hapur.

Radoiçiq e pranoi më vonë përgjegjësinë për organizimin dhe udhëheqjen e sulmit dhe prokurorët e Kosovës ngritën aktakuzë kundër tij së bashku me 44 të tjerë për akuza për terrorizëm, duke pretenduar se grupi synonte të përdorte dhunë për ta shkëputur veriun e Kosovës dhe për t'ia aneksuar Serbisë. Qeveria e Kosovës, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së z. Joseph Borrell⁹² dhe Parlamenti Evropian e⁹³ klasifikuan incidentin e Banjskës si sulm terrorist, me Kuvendin e Kosovës që bëri thirrje për hetim ndërkombëtar për përfshirjen e dyshuar të shtetit serb. Megjithatë, ndryshe nga masat e përkohshme të vendosura ndaj Kosovës, BE-ja (qartësisht për shkak të vetos së disa shteteve të BE-së me lidhje të ngushta me udhëheqjen serbe)⁹⁴ nuk arriti të miratojë masa ndëshkuese kundër Serbisë, pavarësisht se kjo e fundit paraqiste kërcënime shumë më të rënda ndaj situatës së sigurisë në Kosovë dhe rajonin më të gjerë.

Në mars 2026 u hoqën të gjitha masat e vendosura nga BE-ja ndaj Kosovës.⁹⁵ Megjithatë, gjatë kësaj periudhe në Kosovë u zbatuan shumë pak projekte dhe iniciativa të BE-së.

4.3. Përgjigja institucionale e Kosovës ndaj kërcënimeve në rritje të sigurisë: transformimi i sektorit të mbrojtjes

Për shkak të shqetësimeve të sigurisë të shpjeguara më lart në katër komunitat e veriut të Kosovës – përfshirë kërcënimet e drejtpërdrejta të

përshtetëzimit nga Serbia – dhe frikës në rritje se Rusia, pas nisjes së luftës për pushtimin e Ukrainës, mund të synojë të ndikojë në grupet nacionaliste

90 Serbia merr në mbajtje tre policë të Kosovës, Kosova thotë se janë "rrëmbyer", France 24, 15 qershor 2023, <https://www.france24.com/en/europe/20230614-serbia-detains-three-kosovo-police-officers-kosovo-says-they-were-kidnapped>.

91 Prishtina Insight, "Kosova ngre aktakuzë kundër 45 personave për sulmin vdekjeprurës nga grupi i armatosur serb në Banjskë", 11 shtator 2024, <https://prishtinainsight.com/kosovo-indicts-45-for-deadly-attack-by-armed-serb-group-in-banjska/>

92 Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm (EEAS), "Kosovë: Përfaqësuesi i Lartë Borrell flet me Kryeministrin Kurti dhe Presidentin Vuçiq pas sulmit në Banjskë", 25 shtator 2023, https://www.eeas.europa.eu/eeas/kosovo-high-representative-borrell-speaks-prime-minister-kurti-and-president-vu%C4%8Di%C4%87-following-attack_en

93 Parlamenti Evropian, "Serbia dhe Kosova duhet të punojnë për de-eskalimin e situatës në veri të Kosovës", Komunikatë për shtyp, 19 tetor 2023, <https://www.europarl.europa.eu/news/en/press-room/20231013IPR07135/serbia-and-kosovo-must-work-to-de-escalate-the-situation-in-northern-kosovo>.


94 BiEPAG, Një trekëndësh mosbesimi: Bastet e zgjerimit të Hungarisë në Serbi dhe Kosovë, Përmbledhje e Politikave Nr. 206, prill 2024, <https://www.biepag.eu/wp-content/uploads/2024/04/policy-brief-a-triangle-of-mistrust-hungarys-enlargement-stakes-in-serbia-and-kosovo-206.pdf>.

95 Ballkani Perëndimor Evropian, "Udhëheqësit e Kosovës mirëpresin heqjen e të gjitha masave ndëshkuese të BE-së", Ballkani Perëndimor Evropian, 18 mars 2026, <https://europeanwesternbalkans.com/2026/03/18/kosovo-leaders-welcome-lifting-of-all-eu-punitive-measures/>.

serbe për të ndezur konfliktin në Ballkan (veçanërisht në veri të Kosovës) në mënyrë që të largojë vëmendjen dhe mbështetjen perëndimore nga Ukraina, Institucionet e Kosovës u detyruan t'i rrisin me shpejtësi investimet në sektorët e policisë dhe mbrojtjes-. Për pasojë, viteve të fundit janë rritur ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes në Kosovë, duke u rritur nga 69 milionë euro në vitin 2021 në

97 milionë euro në vitin 2022, 116.4 milionë euro në vitin 2023, 153 milionë euro në vitin 2024 dhe 208 milionë euro në vitin 2025.⁹⁶ Veç kësaj, kryeministri Albin Kurti ka zotuar më shumë se 1 miliard euro për mbrojtjen gjatë periudhës katërvjeçare nga viti 2026 deri në vitin 2029, duke demonstruar vendosmërinë e Kosovës për të zhvilluar kapacitete të besueshme frenuese.⁹⁷

RRITJA E BUXHETIT TË KOSOVËS PËR MBROJTJEN 2021 -2025



Megjithatë, rritja e shpenzimeve buxhetore nuk është masa e vetme e ndërmarrë nga institucionet e Kosovës si kundërpërgjigje ndaj kërcënimeve në rritje të sigurisë. Gjatë katër viteve të fundit, qëllimet e transformimit të sektorit të mbrojtjes janë zgjeruar shumë përtej ambicieve fillestare të vendosura në vitin 2018. Teksa plani origjinal theksonte kapacitete thjesht mbrojtëse dhe shmangte veprimet që mund të perceptoheshin si provokuese, ndryshimet e reja në Ligjin për FSK-në i kanë hequr kufizimet e mëparshme në numrin e trupave dhe zhvillimin e kapaciteteve sulmuese.⁹⁸ Kjo tani ua lejon institucioneve të Kosovës të synojnë pajisjen me armë precize me rreze më të gjatë, sisteme të përmirësuara të inteligjencës dhe

mbikëqyrjes dhe forca të lëvizshme sulmuese të afta për t'iu përgjigjur shpejt inkursioneve.

Kosova gjithashtu ka iniciuar përpjekje konkrete për zhvillimin e industrisë së mbrojtjes, duke përfshirë marrëveshjet me Turqinë për krijimin e një fabrike municionesh në përputhje me standardet e NATO-s dhe diskutimet e vazhdueshme në lidhje me prodhimin e dronëve.⁹⁹ Plane të ngjashme janë përmendur edhe në kuadër të marrëveshjes trepalëshe të mbrojtjes Kosovë-Shqipëri-Kroaci: përveç rritjes së ndërveprueshmërisë ushtarake dhe trajnimit të përbashkët, palët kanë theksuar edhe planet afatshkurtra për të zhvilluar sinergji në industrinë e mbrojtjes, duke përfshirë investime

⁹⁶ Raporti i Evropës Qendrore, "Ballkani Perëndimor rrit ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes", Raporti i Evropës Qendrore, 7 prill 2026, <https://www.cereport.eu/news/politics/83394>

⁹⁷ Ballkani Perëndimor Evropian, "Kurti rizgjidhet si kryeministër, qeveria aprovon projektligjin për Planin e BE-së për Rritje Ekonomike", Ballkani Perëndimor Evropian, 12 shkurt 2026, <https://europeanwesternbalkans.com/2026/02/12/kurti-re-elected-as-pm-government-approves-draft-law-on-eu-growth-plan/>.

⁹⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 06/L123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës (i ndryshuar/plotësuar me Ligjin Nr. 08/L157 të 30 nëntorit 2022 dhe me Ligjin Nr. 08/L276 të 27 dhjetorit 2024), Aktet e Konsoliduara Ligjore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18375&langid=2>.

⁹⁹ Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Nënshkruhet marrëveshja me prodhuesin shtetëror turk të industrisë së mbrojtjes "Makine ve Kimya Endüstrisi" për funksionalizimin e fabrikës së municioneve në Kosovë", 16 dhjetor 2024, <https://kryeministri.rks-gov.net/en/news/agreement-signed-with-turkish-state-owned-defence-industry-producer-makine-ve-kimya-endustrisi/>.

të koordinuara, kapacitete të përbashkëta prodhuese dhe përaftrim më të ngushtë të kapaciteteve teknologjike dhe industriale midis tre vendeve.¹⁰⁰ Ndërkohë, Kosova shpreson për përparim të fuqishëm kur bëhet fjalë për krijimin e bashkëpunimit formal me NATO-n me aspiratën e qartë për anëtarësim dhe, siç do të shtjellohet më poshtë, pret me padurim të zgjerojë bashkëpunimin e saj me BE-në edhe në sektorin e mbrojtjes.

Përkundër këtyre planeve ambicioze për të rritur bashkëpunimin në sektorin e mbrojtjes, aspekti

negativ është se Kosovës ende nuk ka legjislacion gjithëpërfshirës që rregullon industrinë e mbrojtjes, duke krijuar pasiguri juridike për investitorët potencialë.¹⁰¹ Ekzistojnë plane për të krijuar një park të dedikuar të industrisë së mbrojtjes me infrastrukturë të specializuar dhe aranzhime sigurie të modeluara sipas praktikave kroate, megjithëse tranzicioni nga planifikimi në funksionalizimin e zonës industriale do të kërkojë investime të konsiderueshme dhe zhvillim rregullator.¹⁰²

4.4. Pasqyra e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes

Bashkimi Evropian ka luajtur rol qendror dhe të shumanshëm në zhvillimin e Kosovës pas konfliktit, duke u bërë investitori më i madh në vend, ndërkohë që i duhet të menaxhojë kufizimet politike të krijuara nga pesë shtetet anëtare që nuk e njohin. Angazhimi i Unionit filloi përmes pjesëmarrjes në UNMIK (1999-2008), duke u pasuar nga dislokimi i EULEX-it pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Si misioni më i madh civil i BE-së deri më sot,¹⁰³ EULEX-i kombinoi monitorimin, mentorimin dhe këshillimin me autoritetin e drejtpërdrejtë për të hetuar dhe ndjekur penalisht raste të ndjeshme, përfshirë krimet e luftës dhe korrupsionin e nivelit të lartë. Po ashtu, BE-ja ka qenë investitori më i madh në tranzicionin e Kosovës pas pavarësisë. Megjithatë, qëndrimi neutral i BE-së, i formësuar nga pozicioni i pesë shteteve anëtare që nuk e njohin Kosovën, ka krijuar gjithashtu komplikime për proceset integruese të vendit. Kjo ka qenë veçanërisht e dukshme në sektorin e mbrojtjes, ku Unioni e ka shmangur përgjithësisht përfshirjen e drejtpërdrejtë me Ministrinë e Mbrojtjes ose Forcën e Sigurisë së Kosovës për të mos duplikuar rolin parësor të NATO-s në mentorimin dhe mbështetjen e këtij sektori. Në vitet 2008-2009, pas shpalljes së pavarësisë, NATO dhe BE-ja u përballën me dilema të ngjashme, për shkak të të njëjtave vende që nuk e

njohin Kosovën. Prandaj, kjo ndarje e përgjegjësi në lidhje me FSK-në u bë për qëllime strategjike dhe praktike: NATO, përmes misionit të KFOR-it të pranishëm që nga viti 1999, ishte në pozicionin më të mirë për të zhvilluar institucionet e mbrojtjes së Kosovës, ndërsa BE-ja, e cila nuk ishte ende nuk është akter i orientuar drejt mbrojtjes, e përqendroi angazhimin e saj në zhvillim më të gjerë institucional dhe jo në strukturat e mbrojtjes. Përndryshe, qasja e NATO-s ndaj Kosovës është karakterizuar si edhe më e ngurtë se neutraliteti kreativ i BE-së, duke e kufizuar bashkëpunimin në ndërveprime të zgjeruara pa korniza formale partneriteti, përkundër mbështetjes dërrmuese publike për anëtarësimin në NATO të Kosovës, me afërsisht 90 për qind të qytetarëve të vendit që e mbështesin këtë.¹⁰⁴ Shkaku i saj, marrëdhëniet e drejtpërdrejta politike ndërmjet NATO-s dhe Kosovës kanë pasur përparim minimal që nga viti 2018, kryesisht për shkak të shteteve mosnjohësve, edhe pse misioni i NATO-s i KFOR-it me rreth 5,200 trupa vazhdon të mbështesë zhvillimin e FSK-së duke e injoruar formalisht procesin e shndërrimit që filloi në vitin 2018. Tani e tutje, situata e Kosovës sa i përket bashkëpunimit me BE-në në fushën e mbrojtjes ndryshon nga marrëdhëniet e saj me NATO-n në mënyra të rëndësishme.

100 Shqipëria, Kroacia dhe Kosova, Deklarata e Përbashkët për Bashkëpunimin në Fushën e Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, 22 mars 2025, <https://www.mod.gov.al/eng/newsroom/1805-albania-croatia-and-kosovo-sign-joint-declaration-on-defence-cooperation>

101 Intervistë cilësore me një zyrtar të MM-së, shkurt 2026

102 Po aty

103 Këshilli i Bashkimit Evropian, "EULEX-i: Këshilli rinovon mandatin e misionit civil të BE-së në Kosovë*", njoftim për shtyp i Këshillit, 17 qershor 2025, <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2025/06/17/eulex-council-renews-the-mandate-of-the-eu-civilian-mission-in-kosovostar/>

104 BalkanWeb, "Instituti Republikan Ndërkombëtar: Kosova dhe Shqipëria, vendet më pro-perëndimore në Ballkanin Perëndimor", BalkanWeb, 29 prill 2024, <https://www.balkanweb.com/en/international-republican-institute-kosovo-and-albania-the-most-pro-western-countries-in-the-western-balkans/#gsc.tab=0>

Vlen të përmendet sidomos që Kosova veç e ka një rrugë të shpallur për anëtarësim në BE si vend potencial kandidat,¹⁰⁵ duke krijuar korniza institucionale për integrim gradual që nuk ekzistojnë me NATO-n. BE-ja ka demonstruar fleksibilitet më të madh në zhvillimin e zgjidhjeve kreative për të akomoduar ndjeshmëritë politike duke ruajtur bashkëpunimin funksional, siç reflektohet në operacionet e qëndrueshme të EULEX-it, perspektivën e anëtarësimit në BE dhe rolin lehtësues në dialogun Kosovë-Serbi. Ky kreativitet i demonstruar në qasjen e neutralitetit të BE-së ndaj statusit të Kosovës ofron shabllone të mundshme për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes, modele këto të afta për t'i kapërcyer kundërshtimet individuale të shteteve anëtare duke prioritetuar

interesat kolektive evropiane të sigurisë.

Marrëdhëniet dypalëshe janë esenciale në këtë kontekst. Kosova ka ngritur partneritete të rëndësishme në fushën e mbrojtjes me Gjermaninë, Italinë, Francën, Austrinë, shtetet baltike, vendet skandinave, Kroacinë dhe shumicën e anëtarëve të tjerë të BE-së që e njohin Kosovën. Këto vende mund të ndihmojnë në promovimin e mekanizmave inovativë të përfshirjes brenda kornizave të mbrojtjes së BE-së. Këto partneritete dypalëshe ofrojnë mundësi bashkëpunimi të menjëhershme duke ndërtuar momentum politik për angazhimin eventual institucional me mekanizmat e mbrojtjes së BE-së si Agjencia Evropiane e Mbrojtjes.

4.5. Pikat e hyrjes për rritje të bashkëpunimit Kosovë-BE në fushën e mbrojtjes

Përkundër pengesave të mëdha politike të krijuara nga mosnjohja, ekzistojnë pika të shumta potenciale të hyrjes për Kosovën për t'u angazhuar me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes dhe sektorin më të gjerë të mbrojtjes së BE-së, të diferencuara sipas afatit kohor, fizibilitetit politik dhe kërkesave institucionale.

a. Kontributet në misionet e CSDP-së

Edhe pse Kosova aktualisht nuk merr pjesë në asnjë mision të CSDP-së, përtej pranimit të EULEX-it, ajo ka treguar gatishmëri të qartë për të kaluar nga statusi i vendit pranues të mbështetjes paqeruajtëse dhe stabilizuese në kontribues në operacionet ndërkombëtare të paqes dhe sigurisë. Ky ndryshim pasqyron zhvillimin e kapaciteteve praktike dhe përkushtimin më të gjerë politik dhe psikologjik për ta shpërblyer reciprokisht mbështetjen ndërkombëtare të pranuar gjatë dhe pas konfliktit 1998-1999. Kosova gjithashtu përfiton nga përvoja e gjerë në pranimin e misioneve ndërkombëtare, pasi që ka shërbyer si vend dislokimi për misionin e KFOR-it të NATO-s që nga viti 1999 dhe për EULEX-in që nga viti 2008. Ky ekspozim afatgjatë i ka ofruar

personelit të Kosovës mundësinë t'i kuptojnë mirë standardet operationale ndërkombëtare, kërkesat logjistike dhe praktikat e koordinimit civilishtarak. Prandaj, pjesëmarrja në misionet e CSDP-së do të demonstronte besueshmërinë e Kosovës si partnere, do të rrisë ndërveprueshmërinë me shtetet anëtare të BE-së dhe do të siguronte përvojë të vlefshme operationale që nuk mund të përsëritet vetëm përmes stërvitjeve trajnuese.

Kosova duhet të prioritetizojë edhe Partneritetin me BE-në për Sigurinë dhe Mbrojtje, në mënyrë të ngjashme me marrëveshjet e bëra nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Një partneritet i tillë do t'ia mundësonte Kosovës të marrë pjesë në misionet e BE-së dhe të vepronte si portë për bashkëpunim me EDA-n dhe instrumentet dhe iniciativat e tjera të BE-së që lidhen me mbrojtjen.

b. Rruga e Bashkëpunimit të Drejtpërdrejtë me EDA-n

Rruga e Bashkëpunimit të Drejtpërdrejtë me EDA-n përfaqëson qasjen më të drejtpërdrejtë, por politikisht sfiduese. Pengesa themelore është kërkesa për aprovim unanime të aranzhimeve administrative nga të gjithë 27 ministrat e mbrojtjes

¹⁰⁵ Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm, "BE-ja dhe Kosova", ueb faqja e EEAS-it, qasar në shkurt 2026, https://www.eeas.europa.eu/kosovo/eu-and-kosovo_en?s=321

që shërbejnë në Bordin Drejtues të EDA-s, sepse shtetet mosnjohëse janë në gjendje t'i bllokojnë aranzhimet e tilla edhe nëse shtetet mbështetëse shtyjnë për përfshirje. Megjithatë, ekzistojnë precedentë për zgjidhje kreative institucionale: aranzhimi administrativ me Serbinë i vitit 2013 tregon se shtetet jo-BE të Ballkanit Perëndimor mund të arrijnë bashkëpunim formal me EDA-n; aranzhimi me Ukrainën i vitit 2015 tregon se vendet në situata komplekse politike mund të akomodohen;¹⁰⁶ dhe përditësimi i vitit 2025 i aranzhimit me Zvicrën tregon se kornizat ekzistuese mund të modernizohen dhe zgjerohen¹⁰⁷.

Thënë kjo, Kosova duhet të jetë e vetëdijshme për sfidat dhe duhet të ndjekë një qasje graduale duke filluar urgjentisht me konsultime teknike joformale për fusha me interes të ndërsjellë si siguria kibernetike, ku ekzistojnë kapacitetet dhe domosdoshmëritë e sigurisë krijojnë stimuj për bashkëpunim. Aranzhimet funksionale të bashkëpunimit të fokusuara në fusha specifike – mbrojtja kibernetike, mbështetja mjekësore, deminimi – mundet që për momentin të rezultojnë më të arritshme politikisht sesa aranzhimet gjithëpërfshirëse administrative, duke i lejuar Kosovës të demonstrojë vlerë duke ngritur besimin mes shteteve anëtare hezituese.

c. Angazhimi i Kolegjit Evropian të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Angazhimi i ESDC ofron një pikë të hyrjes më pak të ngarkuar politikisht dhe të fokusuar në edukim dhe trajnim në vend të bashkëpunimit operacional ose prokurimit. Kosova mund të synojë të formalizojë pjesëmarrjen në aktivitetet e trajnimit të ESDC-së, programet e shkëmbimit dhe iniciativat për hulumtime, duke ngritur marrëdhënie institucionale, duke demonstruar kompetencë profesionale, si dhe duke shmangur ndjeshmëritë politike të bashkëpunimit operacional ushtarak. Një angazhim i tillë do të zhvillonte kapitalin njerëzor brenda institucioneve të mbrojtjes së Kosovës, do të rriste ndërveprueshmërinë përmes edukimit të përbashkët profesional dhe do të krijonte rrjete ndërmjet personelit të mbrojtjes së Kosovës dhe homologëve të tyre të BE-së që mund të lehtësojnë

bashkëpunimin në fusha të tjera me kalimin e kohës.

d. Mekanizmat alternativë dhe plotësues

Përtej drejtimeve tradicionale EDA-s ekzistojnë edhe disa rrugë premtuese. Iniciativa e BE-së për Mbrojtjen e Demokracisë, e cila fokusohet në mbrojtjen e vlerave dhe institucioneve demokratike evropiane nga kërcënimet hibride, ka dhënë indikacione se Kosova do të përfshihet sipas zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Pjesëmarrja formale në këtë iniciativë mund të krijojë precedent për përfshirjen e Kosovës në mekanizmat e sigurisë së BE-së, përkundër pengesave të mosnjohjes.

Prokurimi i përbashkët me shtetet anëtare të BE-së, veçanërisht ato me politika mbështetëse ndaj Kosovës si Gjermania, Franca, Kroacia ose shtetet baltike, përfaqëson një qasje pragmatike që mund të sigurojë qasje në çmime më të mira, ofrim më të shpejtë dhe pajisje të ndërveprueshme gjatë ngritjes së marrëdhënieve dypalëshe të mbrojtjes. Korniza e Gatishmërisë 2030, megjithëse nuk i përfshin shprehimisht mekanizmat për vendet candidate të BE-së për qasje në kreditë e instrumentit SAFE, mundëson pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta të prokurimit që përfshijnë të paktën dy vende, duke sugjeruar se Kosova mund të shqyrtojë nëse aranzhimet trepalëshe (Kosova plus dy shtete të BE-së) mund të mundësojnë pjesëmarrje në iniciativa të përbashkëta të prokurimit.

e. Bashkëpunimi dypalësh në fushën e mbrojtjes

Marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes me shtetet anëtare të BE-së ofrojnë rrugën më të realizueshme dhe duhet të prioritetizohen në strategjinë afatshkurtër. Vende si Kroacia, e cila ka zhvilluar me sukses industrinë e mbrojtjes gjatë procesit të integritimit në BE, mund të shërbejnë si modele dhe partnerë për zhvillimin industrial të Kosovës. Gjermania dhe Franca, si fuqitë kryesore të mbrojtjes së BE-së dhe njohëse

106 Agjencia Evropiane e Mbrojtjes, "Aranzhimi administrativ mes Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes dhe Ukrainës", dokumenti i EDA-s, qasur më 16 mars 2026, <https://eda.europa.eu/docs/default-source/documents/aa---eda---ukraine-mod-07-12-15.pdf>.

107 Departamenti Federal Zviceran i Mbrojtjes, Mbrojtjes Civile dhe Sportit (DDPS), "Raporti për Politikën e Sigurisë", ueb faqja e Qeverisë Zvicerane, qasur më 16 mars 2026, https://www.vtg.admin.ch/en/newsb/jqeY1_dgilyb3wlO2pZqUs.

të Kosovës, mund të ofrojnë mbështetje politike për mekanizmat kreativë të përfshirjes duke ofruar bashkëpunim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e kapaciteteve. Vendet skandinave (Finlanda, Suedia,

Danimarka) kanë demonstruar qasje të sofistikuara ndaj bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe mund të jenë të gatshme të krijojnë korniza inovative për angazhimin e Kosovës.

4.6. Strategjia me faza për bashkëpunim të zgjeruar

Kosova ende nuk ka një strategji të artikuluar qartë dhe me faza për bashkëpunim të zgjeruar me Bashkimin Evropian. Për shpjegimin e këtij hendeku ndihmojnë disa faktorë. Së pari, Kosova nuk e ka konsoliduar plotësisht sektorin e saj të mbrojtjes, edhe pse afati i shndërrimit deri në vitin 2028 po afrohet me shpejtësi. Së dyti, zhvillimi i sektorit të mbrojtjes në Kosovë është realizuar kryesisht nën ombrellën e NATO-s. Kur Kosova filloi të hedhë themelet e institucioneve të saj të mbrojtjes, misioni KFOR i NATO-s veç ishte i pranishëm, ndërsa BE-së i mungonin instrumente specifike për mbrojtjen të krahasueshme me ato të NATO-s. Kjo dinamikë u përforcua më tej nga qasja neutrale e BE-së ndaj statusit, e formësuar nga mosnjohja e Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së.

Megjithatë, ndryshe nga NATO – e cila është përmbajtur nga krijimi i kornizave formale të bashkëpunimit me Kosovën – BE-ja veç ka rekorde angazhimi, veçanërisht përmes EULEX-it, perspektivës së anëtarësimit dhe lehtësimit të dialogut Kosovë-Serbi. Për më tepër, zhvillimet e fundit gjeopolitike e kanë përshpejtuar evolucionin e BE-së si akter i sigurisë dhe mbrojtjes, me ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur pikërisht në fushën e mbrojtjes. Për pasojë, bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe BE-së në sektorin e mbrojtjes është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm. Kjo nënvizon nevojën urgjente për një strategji gjithëpërfshirëse, të sekuencuar në horizonte afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, me prioritetet të qarta dhe pritje realiste të formësuar nga kufizimet ekzistuese politike.

Që të ndodhë kjo, institucionet e Kosovës duhet t'i bëjnë detyrat e shtëpisë dhe duhet të ndërmarrin angazhim të sofistikuar diplomatik. Ndër të tjera, këto institucione duhet të investojnë sistematikisht në marrëdhëniet dypalëshe me Gjermaninë, Francën dhe vendet skandinave për të kultivuar kampionë për bashkëpunimin me Kosovën

në fushën e mbrojtjes; të ngrënë kapacitetet e brendshme në kuadër të departamentit për bashkëpunim ndërkombëtar të Ministrisë së Mbrojtjes për të siguruar gatishmërinë institucionale për të menaxhuar kornizat komplekse të partneritetit kur të shfaqen mundësitë; të bëjnë investime në arsimin profesional dhe teknik të orientuar drejt industrisë dhe teknologjisë së mbrojtjes; të ndërmarrin veprime legjislative të miratohet korniza rregullatore gjithëpërfshirës për industrinë e mbrojtjes; të forcojnë mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të mbrojtjes për të zbutur risqet e korrupsionit; dhe të ndërmarrin komunikime strategjike duke theksuar propozimin unik të vlerës së Kosovës, duke përfshirë mbështetjen më të lartë popullore për integrimin euroatlantik në Evropë, besnikërinë e dëshmuar ndaj partnerëve perëndimorë, kapacitetet specifike në fushat e teknologjisë në zhvillim si siguria kibernetike dhe TIK-u dhe risqet e sigurisë të krijuara nga izolimi i vazhdueshëm i Kosovës.

Më poshtë do të ofrohet një pasqyrë e shkurtër se çka do të nënkuptonin prioritetet realiste, por edhe ambicioze afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të institucioneve të Kosovës kur bëhet fjalë për zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes:

i. Prioritetet afatshkurtra (2026-2027)

Faza afatshkurtra duhet të fokusohet në prioritzimin e bashkëpunimit me BE-në në fushën e mbrojtjes përmes një fushate diplomatike të përqendruar në angazhimin me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes (EDA), krahas punës për marrëveshje dypalëshe në fushën e mbrojtjes, veçanërisht në aspektin e prokurimit të përbashkët. Prioritetet kyçe duhet të përfshijnë gjithashtu përshpejtimin e zhvillimit të një zone industriale të mbrojtjes, përfundimin e aranzhimeve administrative me

CSDP-në, intensifikimin e përpjekjeve të lobimit me shtetet anëtare të BE-së dhe rritjen e pjesëmarrjes në operacionet ndërkombëtare paqeruajtëse. Rezultatet e pritura përfshijnë fillimin e angazhimit formal diplomatik me institucionet e mbrojtjes së BE-së, krijimin e aranzhimeve fillestare të prokurimit të përbashkët dhe krijimin e infrastrukturës themelore për zhvillimin industrial të mbrojtjes.

Paralelisht, Kosova duhet të avancojë reformat e brendshme institucionale duke miratuar kornizën e nevojshme legjislative, duke përfshirë legjislacionin gjithëpërfshirës që rregullon industrinë e mbrojtjes. Prioritet duhet t'i jepet edhe zhvillimit të kapaciteteve vendore të industrisë së mbrojtjes, siç është caktimi i zonës ku do të ndërtohet parku i industrisë së mbrojtjes dhe forcimi i bashkëpunimit dypalësh të fokusuar në iniciativat e përbashkëta të mbrojtjes, duke përfshirë prodhimin e armëve dhe municioneve.¹⁰⁸

ii. Objektivat afatmesme (2028-2030)

Afati kohor afatmesëm duhet të ketë si cak pjesëmarrjen aktive në projektet rajonale të mbrojtjes të mbështetura nga BE-ja, ngritjen e bashkëpunimit të avancuar dypalësh me

shtetet kryesore të BE-së me qëllim ngritjen e partneriteteve të veçanta, ndërtimin dhe përdorimin e parkut të industrisë së mbrojtjes, ngritjen e aftësisë prodhuese fillestare të armëve dhe municioneve; zhvillimin e kapaciteteve të avancuara në fusha të veçanta si siguria kibernetike dhe TIK-u, përfundimin e shndërrimit të FSK-së deri në vitin 2028 dhe punën për arritjen e aranzhimeve funksionale me EDA-n në fusha specifike. Rezultatet e pritura përfshijnë arritjen e pjesëmarrjes së parë shumëpalëshe, zhvillimin e kapaciteteve të avancuar dhe realizimin e momentin historik të shndërrimit në vitin 2028.

iii. Synimet afatgjata (2030-2035)

Në planin afatgjatë duhet të punohet për integrimin e industrisë së BE-së për mbrojtjen në Kosovë përmes investimeve direkte, diversifikimit të partneriteteve ndërkombëtare përtej Turqisë, avancimit të kapaciteteve teknologjike dhe industriale rajonale përmes bashkëpunimit në Ballkan dhe arritjes së aranzhimit administrativ me EDA-n ose kornizës ekuivalente të bashkëpunimit të institucionalizuar. Rezultatet e pritura përfshijnë integrimin industrial me varësi reciproke, krijimin e rrjetit rezilient të partneritetit dhe arritjen e bashkëpunimit të institucionalizuar.

108 Intervistë me një përfaqësues nga MM-ja, shkurt 2026

V. Konkluzion dhe rekomandime

Punimi tregon se transformimi i shpejtë i mbrojtjes së Bashkimit Evropian që nga viti 2022 ka krijuar një kontekst më të favorshëm për bashkëpunim më të thellë me Ballkanin Perëndimor, por qasja në mekanizmat e mbrojtjes së BE-së mbetet e pabarabartë dhe e kushtëzuar politikisht. Për Kosovën, kufizimi kryesor nuk është mungesa e përafrimit strategjik ose vullnetit politik, por pengesa e vazhdueshme e krijuar nga mosnjohja nga pesë shtetet anëtare të BE-së dhe dinamika që lidhet me dialogun Kosovë-Serbi të lehtësuar nga BE-ja. Në të njëjtën kohë, analiza tregon se sektori i mbrojtjes në Kosovë ka përparuar ndjeshëm, se BE-ja veç ka demonstruar fleksibilitet përmes angazhimit indirekt dhe funksional që i ka kapërcyer këto pengesa politike dhe se ekzistojnë disa pika realiste të hyrjes për bashkëpunim më të thellë, veçanërisht përmes partneriteteve dypalëshe, bashkëpunimit teknik, pjesëmarrjes në misione dhe angazhimit gradual institucional. Prandaj, Kosova duhet të ndjekë një strategji me faza, pragmatike dhe të kalibruar politikisht, e cila kombinon diplomacinë, reformën e brendshme dhe bashkëpunim praktik në fushën e sigurisë.

1. Të bëhet prioritet kryesor politik Partneriteti me BE-në për Sigurinë dhe Mbrojtjen.

Punimi e identifikon një partneritet të tillë – të ngjashëm me ato të lidhur tashmë nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut – si porta më e rëndësishme për pjesëmarrjen më të thellë të Kosovës në bashkëpunimin me BE-në në fushën e mbrojtjes dhe si hap i mundshëm drejt angazhimit më të gjerë me instrumentet e mbrojtjes së BE-së.

2. Të punohet për bashkëpunim gradual dhe funksional me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes.

Në vend që të përqendrohet menjëherë në një aranzhim të plotë administrativ, Kosova duhet të fillojë me bashkëpunim teknik në fushat e theksuara shprehimisht në punim, veçanërisht sigurinë kibernetike, mbështetjen mjekësore, deminim dhe fusha të tjera më pak të ndjeshme politikisht ku mund të demonstron vlerë praktike.

3. Të përdoren partneritete dypalëshe për ngritjen e mbështetjes politike brenda BE-së.

Punimi e bën të qartë se marrëdhëniet dypalëshe të Kosovës me Gjermaninë, Francën, Italinë, Kroacinë, shtetet baltike dhe vendet skandinave janë esenciale jo vetëm për bashkëpunimin e drejtpërdrejtë në fushën e mbrojtjes, por edhe për kultivimin e kampionëve që mund të avokojnë për përfshirjen e Kosovës në kornizat e mbrojtjes së BE-së.

4. Të bëhen përgatitje që Kosova të kontribuojë në misionet e CSDP-së dhe operacionet e tjera ndërkombëtare paqeruajtëse.

Kosova duhet të investojë për kapacitete ligjore, institucionale dhe njerëzore të nevojshme për t'u kthyer në kontribuuese për paqen nga pranueset e misioneve ndërkombëtare. Një pjesëmarrje e tillë do të rrisë ndërveprueshmërinë, do të forconte besueshmërinë e Kosovës si ofruese e sigurisë dhe do t'i përforconte argumentet e saja politike për bashkëpunim më të ngushtë me BE-në në fushën e mbrojtjes.

5. Të ulen fërkimet politike të shmangshme dhe të forcohet përafrimi strategjik me BE-në.

Siç sugjeron rasti i Shqipërisë, integrimin mund ta përshpejtojnë përafrimi i qëndrueshëm me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së, të pasurit e më pak kontesteve me fqinjët dhe trajtimi i kujdesshëm i çështjeve të brendshme. Prandaj, Kosova duhet të sigurojë që veprimet që ndikojnë në marrëdhëniet ndëretnike dhe stabilitetin lokal të kalibrohen politikisht, të koordinohen me partnerët kyç aty ku është e mundur, si dhe të komunikohen në formë strategjike në mënyrë që të ruhet mbështetja e fuqishme nga shtetet përkrahëse anëtare të BE-së dhe të krijohen kushte më të mira për integrim më të shpejtë në BE dhe në fushën e mbrojtjes.

6. Të përafrohen reformat e brendshme me agjendën e re të BE-së për industrinë e mbrojtjes dhe gatishmërinë.

Në përputhje me analizën e Librit të Bardhë për Mbrojtjen Evropiane dhe procesin e transformimit të vetë Kosovës, Kosova duhet të miratojë një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për industrinë e mbrojtjes, të përmirësojë qeverisjen e prokurimeve, të forcojë mbikëqyrjen parlamentare dhe të përshpejtojë zhvillimin e zonës industriale të mbrojtjes të planifikuar. Këto reforma do ta bënin Kosovën partnere më të besueshme për bashkëpunimin e ardhshëm dypalësh dhe të lidhur me BE-në në fushën e mbrojtjes.

VLERËSIMI I MUNDËSIVE PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET BALLKANIT PERËNDIMOR DHE MEKANIZMAVE EVROPIANË TË MBROJTJES, PËRFSHIRË EDA-N, ME THEKSIN TEK KOSOVA

PUBLIKUAR NGA::

© Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

© Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)

AUTORË:

Tringa Naka,

Mentor Vrajolli

DIZAJNI DHE PARAQITJA NGA:

Brand Vision Shpk

Kontakti: +383 45 559 923

Email: brandvision.rks@gmail.com

© **Mohim i përgjegjësisë:** Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung. Ky botim i Konrad-Adenauer-Stiftung shërben vetëm për qëllime informative. Ai nuk mund të përdoret nga partitë politike ose nga aktivistët apo mbështetësit zgjedhorë për qëllime të reklamës zgjedhore.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

355.45:061.1(4-6)(496.51:497-15)

Naka, Tringa

Assessing Opportunities for Collaboration between the Western Balkans and European Defence Mechanisms, Including the EDA, with Emphasis on Kosovo / Tringa Naka, Mentor Vrajolli. - Prishtinë : QKSS, 2026. - 36 f. ; 24 cm.

1. Vrajolli, Mentor

ISBN 978-9951-842-57-0

Rreth QKSS

E themeluar në prill 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është organizatë e specializuar, e pavarur dhe joqeveritare. Qëllimi kryesor i QKSS-së është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën hulumtuese dhe të avokimit në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë (RSS) duke mbështetur programet RSS nëpërmjet hulumtimeve, ngjarjeve, trajnimeve, avokimeve dhe këshillave të drejtpërdrejta të politikës.

Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon një numër të madh të raporteve, dokumente të politikave dhe dokumente të shkurtra të politikave. Gjithashtu, organizon më shumë se 200 evente publike duke përfshirë konferenca, tryeza të rrumbullakëta, debate dhe ligjërata në Kosovë, dhe në bashkëpunim me partnerët regjional dhe ndërkombëtar.

Një sferë e gjerë e aktiviteteve përfshijnë hulumtimet, ndërtimin e kapaciteteve, ndërgjegjësimin dhe avokimin. Puna e QKSS mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë, por pa u kufizuar në reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë; identifikimin dhe analizimin e risqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar; politikën e jashtme dhe bashkëpunimin rajonal; dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Rreth KAS

Konrad-Adenauer-Stiftung është fondacion politik gjerman që u zhvillua nga Shoqata për Punën Edukative Demokristiane, e themeluar në vitin 1955. Prej vitit 1964, mban emrin e Kancelarit të parë Federal, Konrad Adenauer. Ne ndihemi të lidhur me kujtesën dhe trashëgiminë politike të Adenauer; parimet e tij shërbejnë si udhëzime, mision dhe përkushtim për ne. Prandaj, jemi të lidhur politikisht me Unionin Kristian Demokrat të Gjermanisë, por jemi të pavarur financiarisht dhe organizativisht.

Promovimi i demokracisë liberale dhe një ekonomie sociale të tregut, i paqes dhe lirisë, marrëdhënieve transatlantike dhe unifikimit evropian - kjo është çka e përfaqëson Konrad-Adenauer-Stiftung.

Edhe pse puna në Kosovë filloi shumë më herët përmes projekteve të ndryshme, KAS u regjistrua zyrtarisht në Prishtinë në qershor 2007. Prej atëherë, KAS është fokusuar në edukimin politik, edukimin qytetar dhe forcimin e shoqërisë civile, integrimin evropian, mbështetjen e dialogut ndëretnik dhe ndërfaqësor, promovimin e ekonomisë së tregut të lirë dhe tema të tjera, të cilat së bashku me partnerët tanë lokal dhe ndërkombëtarë, i kemi trajtuar përmes seminareve, konferencave, diskutimeve dhe botimeve të shumta.



qkss.org
securitybarometer.qkss.org

